



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në Bashkinë Pukë

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi Auditimin Financiar të ushtruar në

BASHKINË PUKË

Tiranë, 2022

PËRMBAJTJA

SHKURTIME	3
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	4
2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore.....	4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	17
II. HYRJE	19
1. Objekti i Auditimit	19
2. Qëllimi i auditimit	19
3. Identifikimi i çështjes	19
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	19
5. Përgjegjësitë e audituesve	20
6. Kriteret e vlerësimit	20
7. Standardet e auditimit	22
8. Metodot e auditimit.....	23
9. Dokumentimi i auditimit.....	24
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	25
1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Pukë.....	25
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	26
2.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.....	26
2.2. Vlerësimi i Raportimit Financiar.....	50
2.3. Të ndryshme të dalta gjatë auditimit	66
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	68
A. MASA ORGANIZATIVE	68
B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI	73
C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE	74
D. MASA DISIPLINORE	78
V. ANEKSET	Error! Bookmark not defined.

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të Bashkisë Pukë dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore*. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga baza e të dhënave të thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 *Ëpaga*, 602 *Ëshpenzime operative* dhe 230-231 *Ëinvestime*, etj.

2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi, u konstatuan diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera. Niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën 57% deri 99%, gjë që tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Pukë dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara.</p> <p>Të ardhurat e Bashkisë Pukë për vitin 2020 janë realizuar në masën 96%, konkretisht nga 42,408 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 40,787 mijë lekë. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2019 në vitin 2020 kanë qenë 4,298 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar e vitit 2020 ka qenë 111,972 mijë lekë, transferta specifike faktike ka qenë 93,869 mijë lekë, nga FZHR ka pasur një shtesë me vlerën 34,892 mijë lekë. Totali i planifikuar i të hyrave për vitin 2020 ka qenë 458,591 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 86%, pra 394,931 mijë lekë.</p> <p>Përdorimi i të ardhurave për vitin 2020, sipas treguesve të buxhetit, për të ardhurat e veta gjatë vitit 2020 ka qenë 48%.</p> <p>Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 <i>ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë</i>, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 <i>ËPër menaxhimin Financiar dhe</i></p>	<i>Pika 2.1, faqe 25-49</i>	E lartë	Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Pukë, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>Kontrollinö; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ðPër sistemin e taksave vendoreö, i ndryshuar; ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 ðPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareö, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ðPër vetëqeverisjen vendoreö, neni 9 pika 1.3 germa öcö dhe öçö; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ðPër financat e vetëqeverisjes vendoreö, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 ðPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitö, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, ðPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020ö; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 ðPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendorö, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 ðPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendoreö; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 ðPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëmö dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.</i></p>			
2	<p>Nga auditimi u konstatua se niveli i realizimit të investimeve të planifikuara paraqitet i ulët, ku për vitin 2020 është realizuar në masën 72%, ku nga vlera e planifikuar prej 97,867 mijë lekë është realizuar vlera 70,591 lekë me një diferencë prej 27,277 mijë lekë.</p> <p>Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 ðPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëö, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ðPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollinö; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ðPër sistemin e taksave vendoreö, i ndryshuar; ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 ðPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareö, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ðPër vetëqeverisjen vendoreö, neni 9 pika 1.3 germa öcö dhe öçö; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ðPër financat e vetëqeverisjes vendoreö, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 ðPër procedurat standarde të</p>	<p><i>Pika 2.1, faqe 25-49</i></p>	E lartë	<p>Nga Bashkia Pukë, të merren masa që planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar shpenzimet më të domosdoshme për nevojat e bashkisë Pukë.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>zbatimit të buxhetit, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, <i>ËPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020</i>; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 <i>ËPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor</i>, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 <i>ËPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore</i>; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 <i>ËPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm</i> dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.</p>			
3	<p>Për vitin 2020, detyrimet në fund të periudhës ushtrimore janë në shumën 59,251 mijë lekë, nga të cilat me VKB-në nr. 91, datë 27.12.2019, është parashikuar të likuidohet vlera 7,000 mijë lekë, nga të cilat 3,000 mijë lekë, që i përkasin llogarisë 602 dhe 4,000 mijë lekë që i përkasin llogarive 230-231.</p> <p>Nga planifikimi, konstatohet se në fund të vitit 2020, vlera e detyrimeve të planifikuara për vitin buxhetor është më e vogël, nisur nga fakti se planifikimi i buxhetit të vitit pasardhës hartohet dhe miratohet në muajin nëntor dhe detyrimet nuk kanë dalë të gjitha.</p> <p>Në totalin e faturave të pa likuiduara për vitin 2020, faturat e llogarisë 602 paraqiten në shumën 5,692 mijë lekë ose 9.6% të totalit, ku shpenzimet për investime janë në shumën 43,486 mijë lekë ose 73.3% dhe shpenzimet gjyqësore janë në shumën 10,071 mijë lekë ose 17.1% e totalit.</p> <p>Është i pa argumentuar fakti se referuar situatës së pasqyrave financiare të vitit 2020, megjithëse në llogarinë 520 ka gjendje monetare të pa përdorur, përsëri Bashkia Pukë ka detyrime kreditore të pa paguara dhe në vlera të konsiderueshme. Kështu në fund të periudhës së vitit 2019, në llogarinë 520 ka pasur gjendje në vlerën 67,083,955 lekë dhe në fund të vitit 2020 në llogarinë 520 paraqitet në vlerën 82,386,492 lekë. Pavarësisht se një pjesë e këtyre fondeve nuk mund të prekeshin për shkak se kanë qenë të specifikuara nga transfertat, pjesa tjetër mund të ishte përdorur për të shlyer plotësisht ose pjesërisht detyrimet e prapambetura.</p> <p>Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet</p>	<p><i>Pika 2.1, faqe 25-49</i></p>	<p>E lartë</p>	<p>1. Bashkia Pukë, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program dhe radhës së faturave, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.</p> <p>2. Bashkia Pukë, Drejtoria Ekonomike, të marrë masa dhe të paraqesë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave dhe detyrimeve për vendimet gjyqësore në të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën 59,251 mijë lekë, nga faturat e papaguara dhe për vlerën 10,071 mijë lekë nga vendimet gjyqësore (në datën 31.12.2020) si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim të plotë në kontabilitet.</p> <p>3. Bashkia Pukë, të marrë masa që të ardhurat e pa përdorura në fund të vitit, të mos i mbartë në vitin pasardhës, por t'ia përdorë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, kontraktuale dhe gjyqësore, sipas rradhës kronologjike të krijimit të tyre.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Pukë, nga data e faturës së kontraktorit, u konstatua se për vitin 2020, janë pa paguar gjithsej 16 fatura me vlerë 5,209 mijë lekë, nga të cilat 13 fatura i përkasin llogarisë 602, në vlerën 1,494 mijë lekë dhe 3 fatura i përkasin llogarive 230-231, në vlerën 3,715 lekë.</p> <p>Nga auditimi i dokumentacionit për detyrimet ndaj vendimeve gjyqësore, u konstatua se deri në fund të vitit 2019 paraqitet vlera totale prej 10,941 mijë lekë. Gjatë vitit 2020 është likuiduar shuma prej 2,575 mijë lekë dhe mbetet për likuidim shuma prej 10,071 mijë lekë.</p> <p>Sa më sipër, kjo bashki është afër klasifikimit me vështirësi financiare, pasi stoku i detyrimeve të prapambetura paraqitet rreth 17.7% e shpenzimeve vjetore të miratuara.</p> <p>Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 <i>ōPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë</i>, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 <i>ōPër vetëqeverisjen vendore</i>, neni 9 pika 1.3 germa <i>ōcō</i> dhe <i>ōçō</i>; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 <i>ōPër financat e vetëqeverisjes vendore</i>, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 <i>ōPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitō</i>, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; etj.</p>			
4	<p>Nga të dhënat e Pasqyrës A2, bashkëlidhur Raportit përfundimtar të auditimit, konstatohet se <u>për vitin 2019</u>, të ardhurat nga 44,031 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 19,969 mijë lekë ose 45%, pra me një mosrealizim në shumën 24,062 mijë lekë. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga defiçiti i krijuar nga pandemia Covid-19, ndërsa <u>për vitin 2020</u>, të ardhurat nga 42,408 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 40,787 mijë lekë 96%. Në planifikimin e të ardhurave konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve të familjarëve,</p>	Pika 2.1, faqe 25-49	E lartë	Bashkia Pukë, gjatë hartimit të projekt/planit të buxhetit, të planifikojë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e degës së thesarit sipas akt-rakordimeve të financës, buxhetit dhe

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>përfshirë taksën e tokës, nuk është përlllogaritur, pra planifikimi i të ardhurave është bërë me rezervë.</p> <p>Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 <i>“Për Financat e Vetëqeverisjes Vendoreë</i> i ndryshuar, neni 5, <i>“Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendoreë</i>, neni 54, <i>“Raportimi financiarë nënpika c</i>, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 <i>“Për financat e vetëqeverisjes vendoreë</i>, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV <i>“Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhuraveë</i> pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 <i>“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeë</i>, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b.</p>			kontabilitetit.
5	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Pukë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2020 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Pukë SHA me NUIS ðK79121308Sö, e cila është shoqëri aksionare me objekt <i>“Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tijë</i>. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 137,779 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 137,779,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pukë në <i>“Ujësjellës Kanalizime Pukë SHAë</i>, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020, më konkretisht në llogarinë 26 <i>“Pjesëmarrje në kapitalet e vetaë</i> në kundërshtim me UMF nr. 64, datë 22.07.2014 <i>“Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarë</i> me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 <i>“Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata jo materialëë</i> pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 <i>“Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeë</i>.</p>	Pika 2.2 faqe 49-65	E lartë	Bashkia Pukë, nëpërmjet Nënpunësit zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek <i>“Ujësjellës Kanalizime Pukë” Sh.A.</i> me vlerë 137,423,000 lekë, në debi të llog. 26 <i>“Pjesëmarrje në kapitalet e veta”</i> dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.
6	<p>Për vitin 2020 struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 79, datë 27.12.2019. Rezulton se në</p>	Pika 2.2 faqe 49-65	E lartë	Bashkia Pukë, të marrë masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të aseteve, duke

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>strukturën aktuale organizative të Bashkisë Pukë nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të asetëve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, sipas UMF nr. 30, datë 27.12.2011 <i>“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik; nenin 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, UMF nr. 3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike”, me qëllim rritjen e mundësisë e të ardhurave nga dhënia me qira si rjedhojë nuk është krijuar regjistri i asetëve për të gjitha pronat e transferuara nga ish komunat.</i></p>			<p>përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Pukë dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore.</p>
7	<p>Për vitet 2019-2020 janë lidhur dhe zbatuar 11 kontrata në vlerën 108,626,177 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, ministritë e linjës dhe FZHR. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari</p>	<p><i>Pika 2.2 faqe 49-65</i></p>	<p>E lartë</p>	<p>Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Pukë, të kryejë të gjitha veprimet e kontabilizimit sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike për kontratat e lidhura për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, duke pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar që nga çelja e fondeve, me konstatimin e shpenzimit (mbërritja e faturës),</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogarite e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, që kanë lidhje me 7 kontrata, ku vlera e mbetur e palikujduara e tyre prej 33,657,277 lekë nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 <i>“Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”</i> Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 <i>“Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” Kapitulli I, pika 1 dhe Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a, b, c, 18/a, b, Kreu III pika 32.</i></p>			<p>deri në kapitalizmin e aktivitetit dhe jo thjesht, kur ndërhyr pagesa, pasi evidentimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin gradual të tij.</p>
8	<p>Llogaria 231 ÷Për aktive afatgjata materiale÷ më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 153,198,003 lekë, në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 168,337,577 lekë, e cila përfaqëson, vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre, kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 ÷Aktive afatgjata materiale÷. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Drejtoria e financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2020, sipas aneksit nr. 9 pika 2. bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të</p>	Pika 2.2 faqe 49-65	E lartë	<p>Drejtoria Ekonomike të marrë masa për sistemimin e llogarisë 231 ÷Për aktive afatgjata materiale÷, në mënyrë që kjo llogari të pasqyrojë vlerën reale të Aktive afatgjata materiale duke plotësuar dhe mangësitë e dokumentacionit në listat analitike.</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<i>pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme</i> ö, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, òTrajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, òAktive afatgjata materialeö dhe pika 33.			
9	<p>Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Pukë ushtrojnë aktivitetin 3 subjekte të cilat tregtojnë hidrokarbure, karburante. Subjekte të licencuar për tregtimin e lëndëve djegëse nuk ka. Aktualisht, detyrimet për pajisjen me autorizim i ka shlyer vetëm òK.ö Shpk, ndërsa òS.ö Shpk dhe òN. O.ö Shpk vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetet të papajisur me autorizimin përkatës.</p> <p>1. Subjekti òK.ö Shpk, ka kryer pagesat e duhura për licencën e tregtimit të karburanteve, por jo për gazin e lëngshëm dhe rrjedhimisht është debitor për vlerën 100,000 lekë.</p> <p>2. Subjekti òS.ö Shpk, ka aplikuar dhe paraqitur dokumentacion, por dokumentacioni nuk është i plotë dhe vazhdon aktivitetin pa licencë. Ky subjekt është debitor për vlerën e papaguar 1,100,000 lekë.</p> <p>3. Subjekti òN. O.ö Shpk, i cili ushtron aktivitet në njësinë Administrative Gjegjan, Bashkia Pukë nuk disponon informacion. Ky subjekt është debitor për vlerën e papaguar 1,100,000 lekë.</p> <p>Pagesat e kryera deri në momentin e auditimit dhe vlerat debitore janë paraqitur në Pasqyrën A27, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.</p> <p>Vlera e papaguar prej 2,300,000 lekë, përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Pukë. Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajö i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa òbö, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.</p>	<i>Pika 2.1, faqe 25-49</i>	E lartë	Nga Bashkia Pukë, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojnë tarifën e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej 2,300,000 lekë , sipas Anekseve bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Pasqyra A27. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencës/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.
10	Të ardhura të munguara nga dhënia me qera e aseteve të Bashkisë, si troje, toka bujqësore, pyje e kullota. Nga auditimi i	<i>Pika 2.2 faqe 49-65</i>	E lartë	Bashkia Pukë të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>dokumentacionit të disponueshëm në zyrën e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Pukë, u konstatua se për vitin 2020 ka pasur gjithsej 38 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 441,524 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 2 subjekte, në vlerën 19,008 lekë, konkretisht A. B. dhe N. M. në vlerën 9,504 lekë secili. Vlera 19,008 lekë përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Pukë.</p> <p>Krahas hapësirave publike, Bashkia Pukë ka lidhur 17 kontrata me subjekte juridike, me afat nga 1 deri në 35 vjet, nga të cilët është pa likuiduar vlera totale prej 7,448,956 lekë, e cila përbën mungesë të ardhurash për Bashkinë Pukë. Nga kjo vlerë, subjekti E. U. shpk ka shlyer detyrimin gjatë vitit 2021. Rrjedhimisht, vlera debitorë në fund të vitit 2020 ngelet 6,351,472 lekë.</p> <p>Sa më sipër, është në kundërshtim me: ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 <i>ōKodi Civil i Republikës së Shqipërisë</i> i ndryshuar; ligjin nr. 48/2014 <i>ōPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare</i>ō; ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 <i>ōPër tokën</i>ō, i ndryshuar; ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 <i>ōPër tokat bujqësore të pandaraō</i>, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 <i>ōPër tokat bujqësore të pandaraō</i>, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, <i>ōPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitō</i>, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për tōu lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 <i>ōPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreō</i>; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 <i>ōPër procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandaraō</i>, etj.</p>			<p>(përfshirë vlerën e kamatëvonesave) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 6,370,480 lekë, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.</p>
11	<p>Nga auditimi, u konstatua se taksa e ndikimit në Infrastrukturë, për vitin 2020 është realizuar në shumën 889,000 lekë nga 1,319,000 lekë të planifikuara ose në masën 67%.</p> <p>Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2019</p>	<p><i>Pika 2.2 faqe 49-65</i></p>	<p>E lartë</p>	<p>Bashkia Pukë nëpërmjet bashkëpunimit institucional tō kërkojë ASHK-së, Drejtoria Shkodër, që të mos lëshojë dhe të pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>janë dhënë 17 leje legalizimi për 2,670.6 m² ndërtim, me vlerë investimi prej 87,782,622 lekë, në vlerën e taksës prej 438,913 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 136,050 lekë, duke mbetur pa shlyer 10 posedues të lejeve të legalizimit të një sipërfaqeje prej 1,842.8 m², me vlerë 302,863 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Pukë.</p> <p>Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2020 janë dhënë 12 leje legalizimi për 1,042.7 m² ndërtim, me vlerë investimi prej 34,273,549 lekë, në vlerën e taksës prej 171,368 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 96,836 lekë, duke mbetur pa shlyer 4 posedues të lejeve të legalizimit të një sipërfaqeje prej 453.5 m² me vlerë 74,532 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Pukë.</p> <p>Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, <i>ōPër legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeō</i> i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, <i>ōPër sistemin e taksave vendoreō</i>, i ndryshuar; VKB Pukë <i>ōPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Pukëō</i>, etj.</p>			<p>nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Pukë. Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe administrimit të territorit, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e listuar si debitorë në Pasqyrën A5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, bazuar në legjislacionin tatimor.</p>
12	<p>Në bazë të përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga zyra e tatim-taksave vendore në Bashkinë Pukë, rezultoi se janë 90 subjekte debitorë nga biznesi. Numri dhe vlera e debitorëve nga biznesi (për taksat dhe tarifave vendore), krahasuar me vitin 2019 është ulur, nga 106 në 90 biznese, ndërsa vlera debitorë ka ardhur duke u rritur, nga 10,080,960 lekë që ishte në fund të vitit 2019 ka shkuar në 14,909,764 lekë në fund të vitit 2020. Vlera prej 14,909,764 lekë përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë Pukë.</p> <p>Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 <i>ōPër vetëqeverisjen vendoreō</i> i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 <i>ōPër financat e vetëqeverisjes vendoreō</i> i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 <i>ōPër sistemin e taksave vendoreō</i>, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 <i>ōPër Procedurat Tatimoreō</i>, me ndryshime,</p>	Pika 2.2 faqe 49-65	E lartë	<p>Bashkia Pukë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj 90 subjekteve debitore në vlerën prej 14,909,764 lekë (sipas <i>Pasqyrave në Anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>), duke ndjekur rrugët e mëposhtme:</p> <p>a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.</p> <p>b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).</p> <p>c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Kreut XI, <i>õMbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara</i>, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 <i>õKodi Penal i RShõ</i> me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 <i>õPër vetëqeverisjen vendore</i>, i ndryshuar neni 9 <i>õTë drejtat dhe përgjegjësitë</i> pika 1.3., neni 35, <i>õTë ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore</i>, me ligjin nr. 68/2017 <i>õPër financat e vetëqeverisjes vendore</i> i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 <i>õPër sistemin e taksave vendore</i>, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.</p>			<p>për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.</p> <p>d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Pukë, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</p>
13	<p>Nga auditimi u konstatua se regjistrat e familjeve fermere, nuk janë përditësuar sipas të dhënave që duhet të disponojë ZAMT në Bashki dhe në Qark apo ASHK Pukë, për numrin e familjeve që kanë përfituar tokë në bazë të ligjit për ndarjen e tokës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 <i>õPër sistemin e taksave vendore</i>, i ndryshuar, nenet 23 dhe 24.</p> <p>Për vitin 2019 nuk kanë paguar 397 familje, ndërsa për vitin 2020 nuk kanë paguar 490 familje, për një vlerë totale prej 1,001,460 lekë. (Pasqyra A16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p> <p>Vlera prej 211,860 lekë, e cila vjen nga diferenca e familjeve që nuk paguajnë me familjet e përjashtuara me VKB nga pagesa e detyrimeve, përbën të ardhura të munguara për bashkinë Pukë, nga mosarkëtimi i taksave të familjarëve nëpërmjet agentit tatimor Ujësjiellës Kanalizime Puka Sh.A. (Pasqyra A17)</p> <p>Vlera prej 673,946 lekë, nga shuma e të ardhurave të planifikuara por të pa arkëtuara nga Njësitë Administrative Gjegjan, Qerret, Rrapë dhe Qelëz, për vitin 2020, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë.</p> <p>Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 <i>õPër tokën</i>, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 5,313 familje. Për periudhën 2015-</p>	Pika 2.2 faqe 49-65	E lartë	<p>1. Bashkia Pukë, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të hartuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Pukë dhe Qarku Shkodër). Për familjet fermerë debitorë të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën 4,597,864 lekë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.</p> <p>2. Bashkia Pukë, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifatat vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerave debitorë. Gjithashtu Bashkia Pukë të bashkëpunojë me Ujësjiellës Kanalizime Puka Sh.A. për arkëtimin e vlerës debitorë prej 885,806 lekë dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>2020, nga auditimi rezultoi vlera debitorë 4,597,864 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë. Kjo vlerë debitorë është e pakontabilizuar.</p> <p>Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 <i>ōPër sistemin e taksave vendoreō</i>, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 <i>ōPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisēō</i> i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligjin nr. 139/2015 <i>ōPër vetēqeverisjen vendoreō</i> i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 <i>ōPër financat e vetēqeverisjes vendoreō</i> i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, <i>ōPër Taksat Kombētareō</i>, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, <i>ōPër Taksat Kombētareō</i>, etj.</p>			<p>detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative këtij agjenti tatimor.</p> <p>3. Bashkia Pukë, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Pukë, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.</p>
14	<p>Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Sektori i tatim-taksave vendore, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, nga subjektet që kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit, të pajisur me leje ndërtimi nga Bashkia Pukë, 8 prej tyre nuk kanë paguar detyrimet vendore në vlerën totale 260,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Pukë, ndërsa për 4 subjekte nuk ka informacion.</p> <p>Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 <i>ōPër procedurat tatimoreō</i> neni 40, <i>ōRegjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtareō</i>, pika 1, neni 43 <i>ōPërditësimi i të dhënave të regjistrimitō</i> pika 1/1; ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 <i>ōPër Qendrën Kombētare të Regjistrimitō</i>, i ndryshuar, neni</p>	Pika 2.2 faqe 49-65	E lartë	<p>Bashkia Pukë të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruarra për vitet 2019-2020, pavarësisht nëse kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Pukë dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, si dhe të nxjerrin njoftim detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore. Sipas listimit në Anekse, Pasqyra A26 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të ndjekin të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej 260,000 lekë nga këto</p>

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	22, <i>òDetyrimi për regjistrimò, pika 4; ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 òPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò i ndryshuar, VKB, etj.</i>			detyrime vendore.
15	Nga auditimi, u konstatua se fondi i krijuar për emergjencat civile nuk është në masën 4% e shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, ku referuar buxhetit përkatës të vitit 2020, ky fond duhej të ishte në vlerën 18,344 mijë lekë. Buxheti i caktuar nga Bashkia Pukë për emergjencat civile është llogaritur 1.7% e totalit të transfertës dhe të ardhurave të planifikuara për vitin 2020 sipas shkresës të MFE nr. 23189/1 prot., datë 24.12.2019. Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 45/2019, datë 18.07.2019 <i>òPër mbrojtjen Civileò, pika 1 e nenit neni 65 òBuxheti i bashkiveò.</i>	<i>Pika 2.1, faqe 25-49</i>	E mesme	Bashkia Pukë, të marrë masa që në të ardhmen, të parashikojë shpenzimet për emergjencat civile në nivelin e duhur, me qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe sigurimin e mbrojtjes civile për komunitetin.
16	Në fund të vitit 2020 llogaria 466 <i>òKreditorë për mjete në ruajtjeò, paraqitet në vlerën 11,346,594 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se: gjatë vitit 2020 Drejtoria e Financës ka të dokumentuar ngurtësimet në vlerën 11,346,594 lekë për 36 subjekte. Shtesat janë në vlerën 2,723,431 lekë dhe likuidimet e kryera në vlerën 2,110,116 lekë për 3 subjekte. Sipas akt rakordimeve midis Bashkisë Pukë dhe degës së thesarit Pukë, konstatohet se për 29 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 9,188,341 lekë, sipas <i>aneksit nr. 6, pika 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>, nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e thesarit, për të cilat është përbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga drejtoritë e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e</i>	<i>Pika 2.2 faqe 49-65</i>	E mesme	Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë pranë Degës së Thezarit Pukë për rimarrjen e fondeve të ngurtësuara dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Veprimet e mosveprimet janë në kundërshtim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 <i>“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”</i> , Kap. III, pikat 30, 50.			

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Konkluzioni i përgjithshëm

Ne kemi audituar veprimtarinë ekonomiko financiare e Bashkisë Pukë, për periudhën nga data nga 01.01.2020 deri më 31.12.2020, përfshirë pasqyrat financiare, planifikimin dhe realizimin e të ardhurave e shpenzimeve, etj.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe paraqitjen në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në përfundim të auditimit të fushave të mësipërme, për vitin 2020, pas vlerësimit të dokumentacionit, grupi i auditimit të KLSH-së arrin në konkluzionin se përsa i takon shkallës së zbatimit të standardeve mbi raportimin financiar nga subjekti Bashkia Pukë, në përgjithësi jepet një pamje e drejtë dhe e sinqertë e pozicionit financiar dhe performancës financiare, si dhe për lëvizjet e mjeteve monetare, kjo referuar UMFE nr. 8, datë 9.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, duke përjashtuar disa anomali materiale por jo të përhapura që janë baza për dhënien e një opinioni të pamodifikuar mbi pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Pukë.

Opinioni mbi pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Pukë, për vitin ushtrimor 2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i pamodifikuar, me “Theksim çështjeje”¹:

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705², dhe ISSAI 1200³, pasqyrat

¹ **Opinion i pamodifikuar me theksim çështjeje.** Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t’i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si ÷theksimi i çështjes së përfshihen në një paragraf të veçuar nga ai i opinionit.

² Objektiv i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi 5 Theksimi i Çështjesë.

Baza për opinionin e pamodifikuar, me theksim çështjeje:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Pukë, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700). Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pakualifikuar të auditimit.

Theksimi i çështjeve:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Bashkia Pukë, sa i takon llogarive të mëposhtme:

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, është mbivlerësuar për 9,188,341 lekë për vitin 2020;

Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, është nënvlerësuar për shumën 137,423,000 lekë;

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Pukë:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Pukë, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Pukë janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme⁴, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjërë.

³ Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra për sa i takon gjetjeve nga auditimi

⁴ ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra për sa i takon gjetjeve të tij/saj.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *ËPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1111/1 Prot., datë 01.11.2021, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Pukë nga data 01.11.2021 deri në datën 03.12.2021, u krye *ËAuditim Financiar*, për periudhën nga 01.01.2020 deri më 31.12.2020, nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J. P., Përgjegjës Grupi;
2. H. I.

1. Objekti i auditimit

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse **për vitin 2020**, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

2. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, duke mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13)⁵, nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi të shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Ai promovon përgjegjshmëri ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre, duke identifikuar dobësitë dhe devijimet nga ligjet dhe rregulloret, si dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm. Mashtrimi dhe korrupsioni, për shkak të natyrës së tyre, përmbajnë elementë që janë në kundërshtim me transparencën, përgjegjshmërinë dhe administrimin e mirë. Auditimi ka përfshirë veprimet e kryera nëpërmjet bankës, hartimin e pasqyrave financiare, planifikimin dhe mbledhjen e të ardhurave, hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe vlerësimin e evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Pukë.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë, z. Gj. Gj., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. F. P., Drejtore e drejtorisë së administrimit të përgjithshëm, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të

⁵ Planifikimi i kontrollit për pasqyrat financiare të miratuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve

brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore*, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, *ËPër Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSHö*, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *ËPër menaxhimin financiar dhe kontrollinö*, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Pukë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

6. Kriteret e vlerësimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 *ËPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*;
- **Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:**
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 *ËPër menaxhimin financiar dhe kontrollinö*;
- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *ËPër auditimin e brendshëm publikö*;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes Vendore*;
- Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 *ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareö*

- Ligji nr. 99/2018, datë 31.12.2018 *ËPër buxhetin e vitit 2019*ö, Ligji nr. 88/18.12.2019 *ËPër buxhetin e vitit 2020*ö dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje.
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 *ËPër huamarrjen e qeverisjes vendore*ö
- Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 *ËPer pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*ö ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.03.2015;
- VKM 783 datë 22.11.2006 *ËPër përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël*ö;
- VKM nr. 83, datë 03.02.2016 *ËPër Miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*ö.
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 *ËPër zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore*ö;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 *ËPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*ö;
- UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *ËPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*ö, etj;
- Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 *ËPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ö, i ndryshuar;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *ËPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*ö;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 *ËPër shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*ö ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
- Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 *ËPër përgatitjen e buxhetit vendor*ö;
- Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 *ËPër buxhetin e vitit 2018*ö, pikat 82-91 *ËDetyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*ö,
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 *ËPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*ö,
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 *ËPër buxhetin e vitit 2019*ö, pikat 106-110, *ËDetyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*ö, dhe pikat 116-117- *Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore*’’.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, *ËPër përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive*ö), Fletore zyrtare 196/2014;
- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 28, datë 15.12.2011 *ËMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë. e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike*ö;
- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ö i ndryshuar
- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, *ËPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*ö
- Urdhëri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 *ËPër miratimin e manualit të MFK*ö;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik urdhri i ministrit Financave nr. 100, datë 16.10.2017.
- **Në fushën e mbajtjes së Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:**
- Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 *ËPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006*ö, aktualisht i shfuqizuar;
- VKM nr. 248, datë 10.4.1998 *ËPër miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre*ö i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *ËPër përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*ö;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 *ËPër miratimin e procedurave për transferimin e të*

drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorialö;

- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 *öPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huajö;*
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 *öPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshmeö*
- Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financiare nr. 3237 datë 16.07.2015 *öPër procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorialö.*
- **Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:**
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 *öPër procedurat tatimore në RSHö, i ndryshuarö;*
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 *öPër Sistemin e Taksave Lokaleö, i ndryshuar;*
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, *öPër Taksat Kombëtareö, i ndryshuar*
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 *öPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyreö, me ndryshime;*
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, *öPër disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveö;*
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 *öPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëö, i ndryshuar;*
- **Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:**
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 *öKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëö, i ndryshuar;*
- Ligji nr. 152-2013, *öPër Nëpunësin Civilö, i ndryshuar;*
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, *öPër kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeveö, i ndryshuar;*
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, *öPër Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilëö, i ndryshuar;*
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, *öPër Pagat e Vetëqeverisjes Vendoreö, i ndryshuar;*
- *Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;*
- *Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLS-së”;*
- *Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.*
- *Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;*
- *Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.*

7. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 *öParimet themelore të auditimit të sektorit publikö, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;*
- ISSAI 2000-2899 *öUdhëzues të Auditimit Financiarö;*
- ISSAI 2300 *öPlanifikimi i auditimit të pasqyrave financiareö;*
- INTOSAI GOV 9100 *öUdhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 öUdhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëmö;*
- ISSAI 400 *öParimet themelore të auditimit të përputhshmërisëö, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;*

- ISSAI 4000 *Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*; si dhe ISSAI 4200 *Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*;
- INTOSAI *Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

8. Metodatat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pështetja specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

▪ Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

▪ Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, i ndryshuar.

▪ Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme.

Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

▪ **Kontrolli i vlerësimeve**

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

▪ **Konfirmimi nga të tretët**

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtuar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

▪ **Kontrolli sipas një treguesi**

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna ojashtë normalesë, të cilat përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

▪ **Intervista**

▪ **Raporte dhe Informacione**

▪ **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatete këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akt-Konstatimeve, Akt-Verifikimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe Projektraportit të auditimit, u përgatit ky Raportit Përfundimtar Auditimi.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar, si: etika dhe pavarësia, kontrolli i cilësisë, menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre dhe parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitetet, pasivitetet dhe interesat e kapitalit janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënime shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.



III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Pukë

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Puka kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë e Vaut të Dejës, në lindje me Bashkinë Fushë Arrëz dhe në jug me Bashkitë Mirditë dhe Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Pukës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia e Pukës ka 11,069 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 16,836 banorë. Ajo ka një sipërfaqe prej 505.53 km² me një densitet prej 33.3 banorë/km² sipas Regjistrimit Civil dhe 21.89 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Të dhëna të tjera: Bashkia e Pukës është një ndër zonat e pasura minerare të vendit, e cila disponon gjithashtu një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore. Megjithatë, prerja pa kriter e pyjeve ka shkaktuar jo pak probleme për këtë zonë.

Mbyllja e minierave apo dhënia e tyre me koncesion ka shtuar numrin e të papunëve në Pukë, duke e kthyer varfërinë në një problem akut për banorët e zonës. Për shkak të saj, një pjesë e mirë e popullatës ka migruar në drejtim të Shqipërisë së Mesme ose emigruar jashtë Shqipërisë. Të ardhurat nga emigracioni janë një burim i rëndësishëm mbijetese për këtë bashki. Prej vitesh në këtë zonë kanë munguar investimet me rëndësi, ndërsa rruga Durrës-Kukës e ka aneksuar dhe izoluar edhe më shumë Bashkinë e Pukës.

Terreni malor i Pukës është shumë i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit malor; krahas pasurive dhe burimeve natyrore me vlera të mëdha ekonomike që gjenden brenda hapësirës gjeografike të Pukës, kryesisht pyje natyrore, bimë mjekësore, pasuri nëntokësore minerare. Gjatë viteve të fundit, një numër i vogël turistësh janë rikthyer në Pukë për shkak të hapjes së një piste skish dhe ndërtimit të disa haneve. Megjithatë, numri i tyre vazhdon të mbetet i ulët.

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat:

Emri i Njësitë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Pukë	Qyteti: Pukë, Fshatrat: Pukë, Lajthizë
Gjegjan	Fshatrat: Dom, Gjegjan, Gojan i Vogël, Rras, Kuzhnen, Gojan i Madh, Shkozë, Kimëz, Kalivare, Mesul
Rrapë	Fshatrat: Breg, Rrapë, Kabash, Buhot, Bicaj, Blinisht, Lumzi, Meçe

Qelëz	Fshatrat: Qelëz, Bushat, Dushnezë, Midhë, Buzhalë, Dedaj, Levrushk, Ukth, Qerret i Vogël
Qerret	Fshatrat: Qerret, Luf, Dush, Karmë, Kçirë, Luf-Plan, Korthpulë, Kaftall, Tejkodër, Gomsiqe, Vrith, Plet.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit, 2020 si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

2.1.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2020:

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2018-2020, PBA 2019-2021 dhe PBA 2020-2022, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik me urdhër të Titullarit të institucionit, organizimi i mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimi i e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, përmirësimi i rrjetit rrugor rural, menaxhimi i mbetjeve, ndriçimi i rrugëve, riparimi i godinave arsimore si dhe ofrimi i shërbimeve publike vendore. Është bërë analiza e pagave dhe është llogaritur pesha specifike e këtyre llojeve të shpenzimeve në totalin e shpenzimeve.

Si fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

- Përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit;
- Përmirësimi i rrjetit rrugor rural;
- Menaxhimi i mbetjeve urbane;
- Ndriçimi i rrugëve;
- Përmirësimi i kushteve për turizmin;
- Ofrimi i shërbimeve publike;
- Riparimi i objekteve arsimore.

Këto programe afatmesme janë hartuar bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 23 datë 30.07.2018 *“Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësisve të Qeverisjes Vendore”*. Është marrë në konsideratë Instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të *“Buxhetit me pjesëmarrje”*, sipas **Pasqyrës B1**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, ujësjellësi, etj., gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale dhe mbi bazën e tyre si dhe të buxhetit faktik të mundshëm, janë përzgjedhur ato më prioritaret.

PBA-të dhe buxheti i vitit 2020 janë miratuar në Këshillin Bashkiak, si më poshtë:

- PBA 2018-2020 është miratuar me VKB nr. 71, datë 30.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 49/1 datë 22.01.2018;

- PBA 2019-2021 është miratuar me VKB nr. 91, datë 24.12.2018, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 12/1, datë 15.01.2019;
- PBA 2020-2022 dhe buxheti 2020 është miratuar me VKB nr. 91, datë 27.12.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 47/1, datë 14.01.2020.

Planifikimet sipas PBA-ve dhe ndryshimet janë paraqitur në **Pasqyrën B2**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sipas të dhënave të **Pasqyrës B2**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, konstatohet se për vitin 2020 me të ardhurat e veta bashkia mbulon 10% të shpenzimeve. Kështu të ardhurat nga taksat e tarifat vendore janë planifikuar për vlerën 42,408 mijë lekë në fakt ato janë realizuar për vlerën 40,787 mijë lekë, *më pak për vlerën 1,621 mijë lekë*, diferencë e cila ndikon në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara nga të ardhurat për të njëjtën vlerë.

Planifikimi i Buxhetit të Bashkisë Pukë për vitin 2020 është bërë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 *ōPër vetēqeverisjen vendoreō* pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, gërma *ōdhō* të nenit 32, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *ōPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisēō* i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave *ōPër pērgatitjen e buxhetit vendorō*, konkretisht UMF nr. 2, datë 06.02.2012 *ōPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitō*, i ndryshuar me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, në ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 *ōPër buxhetin e vitit 2020ō*, si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkisë Pukë.

Programi i të ardhurave për vitin 2020 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 80 datë 27.12.2019 *ōPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Pukēō*.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2020, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për pērgatitjen e buxhetit të njëjse vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lēvizjet në buxhet. Po kështu rezulton se janë bërë argumentimet e transferimeve të ndryshme të fondeve buxhetore gjatē vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit pērfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

2.1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative.

Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura:

Në programet buxhetore është bërë shpērndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpērmjet transfertēs së pakushtëzuar, transfertēs së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të pērbashkēta si dhe shpērndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinēs buxhetore sipas strukturēs dhe burimeve të financimit. Gjatē vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinē e njëjisē vendore në thesar, vlerat përkatēse të buxhetit vjetor kanë pēsuar ndryshime në kuptimin e vlerēs totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpērblime lindje, etj., të cilat kanë qenē të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhēs.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse *ËPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Pukë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2020, u konstatua se është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit 2020, buxheti i Bashkisë Pukë ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Shkodër.

U verifikuan situacionet mujore të rakorduar me Degën e Thesarit Pukë dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave dhe tarifave të Bashkisë dhe të granteve. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Pukë janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Pukë, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve. Gjatë auditimit, rezulton se Kryetari i Bashkisë ka raportuar normalisht në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare, sipas nenit 64 të ligjit nr. 30/2015 dhe ligjit nr. 139/2015.

Nga sa më sipër, rezulton se kanë gjetur zbatim UMF nr. 1, datë 9.1.1996 *ËPër procedurat e punës në sistemin e thesarit dhe institucioneve buxhetore* dhe UMF nr. 2, datë 27.1.1999 *ËPër urdhër shpenzimet dhe titullin e të ardhurave*.

Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Pukë rezultoi se për vitin 2020, gjendja fillestare e planit të çelur është **434,156 mijë lekë**.

Në muajin Korrik, plani vjetor është shtuar me **7,037 mijë lekë** nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për Rikonstrukcion të godinave në pronësi të NJQV, për strehim social.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është bërë shtesë fondi prej **3,614 mijë lekë** për dyfishim të ndihmës ekonomike gjatë periudhës së pandemisë Covid-19.

Në muajin Dhjetor 2020, nga Ministria e Mbrojtjes është bërë shtesë fondi prej **1,995 mijë** lekë për fatkeqësi.

Diferenca prej 11,789 mijë lekë kanë qenë të trashëguara nga viti paraardhës.

Gjendja në fund të vitit 2020 ka qenë 458,591 mijë lekë.

2.1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit:

Titulli i gjetjes: Diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera.

Situata: Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Pukë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Pukë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuara me Vendim të KB ose të diktuar nga transferta e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit dhe rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.

Realizimi i treguesve të buxhetit për vitin 2020 (shpenzimet), referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në **Pasqyrën B3**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Referuar të dhënave të **Pasqyrës B3**, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën 57 deri 99%, gjë që tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Pukë dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara.

Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit, për vitin 2020 e zënë shpenzimet për paga me 35%, e ndjekur nga Transferta tek individët (ku përfshihet ndihma ekonomike dhe pagesa për paaftësinë e kufizuar me 28%, investimet me 18% dhe shpenzimet operative me 9%.

Referuar të dhënave të **Pasqyrës B4**, të ardhurat e Bashkisë Pukë për vitin 2020 janë realizuar në masën 96%, konkretisht nga 42,408 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 40,787 mijë lekë. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2019 në vitin 2020 kanë qenë 4,298 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar e vitit 2020 ka qenë 111,972 mijë lekë, transferta specifike faktike ka qenë 93,869 mijë lekë, nga FZHR ka pasur një shtesë me vlerën 34,892 mijë lekë. Totali i planifikuar i të hyrave për vitin 2020 ka qenë 458,591 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 86%, pra 394,931 mijë lekë.

Përdorimi i të ardhurave për vitin 2020, sipas treguesve të buxhetit, për të ardhurat e veta gjatë vitit 2020 ka qenë 48%. Përdorimi i të ardhurave sipas zërave dhe në total, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në **Pasqyrën B4**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ Sipas burimeve të financimit:

Për vitin 2020, nga **transferta e pakushtëzuar** treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 141,858 mijë lekë (përfshirë transfertën e trashëguar nga viti 2019) dhe janë realizuar në vlerën 119,952 mijë lekë ose në masën 85%, sipas **Pasqyrës B5**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga **transferta specifike**, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 116,037 mijë lekë (përfshirë transfertën e trashëguar nga viti 2019) dhe janë realizuar në vlerën 98,476 mijë lekë ose në masën 85%, sipas **Pasqyrës B6**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga të **ardhurat e veta**, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 47,420 mijë lekë,

(përfshirë dhe të ardhurat e trashëguara nga viti 2019) dhe janë realizuar në vlerën 24,511 mijë lekë ose në masën 52%, sipas **Pasqyrës B7**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga **fondet e deleguara**, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 118,384 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 117,560 mijë lekë ose në masën 99%, sipas **Pasqyrës B8**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga **fondet e FZHR dhe Ministrisë së Linjës**, treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 34,892 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 34,432 mijë lekë ose në masën 99%, sipas **Pasqyrës B9**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjatë periudhës objekt auditimi, nuk ka pasur financime të huaja.

Sa më sipër u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit/planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, kryesisht për arsye të ardhurave të veta dhe rrjedhimisht shpenzimeve të tyre, konkretisht, nga 47,420 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 24,511 mijë lekë, me një diferencë prej 22,909 mijë lekë, pra pothuajse 52% të planifikimit. Nga ky planifikim i pabazuar në pritshmërinë reale për realizimin e të ardhurave, ka rezultuar mosrealizimi i zërave të rëndësishëm buxhetorë, duke filluar me pagat e sigurimet shoqërore, për të vazhduar me shpenzimet operative në vlerën 9,812 mijë lekë, me transferimet e brendshme në vlerën 1,516 mijë lekë dhe me investimet, në vlerën 10,266 lekë.

Për sa më sipër, përgjegjësia është e z. Gj. Gj., me funksion Kryetar i bashkisë Pukë dhe znj. F. P., me funksion Drejtoreshë e drejtorisë së administrimit të përgjithshëm.

Kriteri: ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *ËPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *ËPër sistemin e taksave vendore*, i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 *ËPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore*, neni 9 pika 1.3 germa òcò dhe òçò; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore*, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *ËPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, *ËPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 *ËPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor*, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 *ËPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisve të vetëqeverisjes vendore*; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 *ËPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm* dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Ndikimi/Efekti: Planifikimi joreal i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Shkak: Planifikim i të ardhurave dhe më pas i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke u mbështetur në planifikim dhe jo në realizimin faktik. Mungesa e një analize financiare në programimin e buxheteve, mosnjerrja e konkluzioneve të sakta për mosrealizimet e buxheteve në periudhat e mëparshme, si dhe mos respektimi i kërkesave ligjore për programimin e buxheteve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Pukë, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës,

duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

➤ **Miratimi i buxhetit faktik:**

Në fund të periudhës ushtrimore nga Bashkia Pukë është miratuar buxheti faktik, ku për vitin 2020 është miratuar me Vendim të KB nr. 17, datë 31.05.2021, bashkë me hartimin e PBA-së 2022-2024. Në relacionin përfundimtar të zbatimit të buxhetit është hartuar vetëm realizimi i treguesve buxhetorë për të ardhurat dhe shpenzimet dhe nuk është shoqëruar me analizë faktoriale për realizimet e fondeve dhe rekomandimet për përmirësimin e situatës.

➤ **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak:**

Në zbatim të nenit 48 *Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor* të ligjit 68/2017 *Për financat e vetëqeverisjes vendore*, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 *Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë* neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 *Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit* i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 *Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore*, si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *Për vetëqeverisjen vendore*, Raportet e monitorimit janë hartuar për çdo 4-mujor të vitit 2020 dhe janë dërguar në MFE si më poshtë:

12 mujori i vitit 2019, është dërguar në MFE me shkresën nr. 327 prot., datë 20.02.2020, miratuar nga KB në datën 04.03.2020;

4 mujori i parë 2020, është miratuar me VKB datë 06.06.2020;

4 mujori i dytë 2020 është miratuar me VKB datë 04.09.2020;

12 mujori i vitit 2020 është dërguar në MFE me shkresën nr. 610 prot., datë 16.03.2021, miratuar nga KB në datën 02.02.2021, ndërsa mendimet për këtë raport kanë ardhur me shkresën e MFE nr. 5825 prot, datë 30.03.2021.

➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës:**

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/i kontigjencës, ku për vitin 2020 është planifikuar në masën 2,559 mijë lekë, e cila nuk është përdorur, pra e gjithë vlera është trashëguar për vitin 2021.

➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile:**

Titulli i gjetjes: Planifikim nën limitin ligjor për emergjencat civile.

Situata: Nga Bashkia Pukë është krijuar edhe fondi për emergjencat civile, ku për vitin 2020 paraqitet në total 4,628 mijë lekë, ku nga buxheti i bashkisë është parashikuar në shumën 2,625 mijë lekë, nga e cila është përdorur vlera 100 mijë lekë. Sipas VKB nr. 25, datë 04.09.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 650/1 datë 16.09.2020, ky fond është përdorur për kompensimin e shpenzimeve për djegie banese të z. G. L., në shumën 100 mijë lekë.

Nga emergjencat civile është përdorur shuma 1,995 mijë lekë, e cila ka ardhur me destinacion dhe është përdorur për dhënie ndihme me rast fatkeqësie familjes së z. P. N..

Konstatohet se fondi i krijuar nuk është në masën 4% e shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, ku referuar buxhetit respektiv të vitit 2020, ky fond duhej të ishte në vlerën 18,344 mijë lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 45/2019, datë 18.07.2019 *Për mbrojtjen Civile*, pika 1 e nenit neni 65 *Buxheti i bashkive*. Buxheti i caktuar nga Bashkia Pukë për emergjencat civile është llogaritur 1.7% e totalit të transfertës dhe të ardhurave të planifikuara për vitin 2020 sipas shkresës të MFE nr. 23189/1 prot., datë 24.12.2019.

Për sa më sipër, përgjegjësia është e z. Gj. Gj., me funksion Kryetar i bashkisë Pukë dhe znj. F. P., me funksion Drejtore e drejtorisë së administrimit të përgjithshëm.

Kriteri: ligji nr. 45/2019, datë 18.07.2019 *Për mbrojtjen Civile*, pika 1 e nenit neni 65 *Buxheti i bashkive*.

Ndikimi/Efekti: Planifikimi nën limitin ligjor i këtij zëri buxhetor, në rast fatkeqësish natyrore etj, mund të shkaktojë mosreagim në kohë dhe rrjedhimisht të rrezikojë jetën dhe pasurinë e popullatës.

Shkaku: Mosnjohje dhe moszbatim i kuadrit ligjor të posaçëm.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Bashkia Pukë, të marrë masa që në të ardhmen, të parashikojë shpenzimet për emergjencat civile në nivelin e duhur, me qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe sigurimin e mbrojtjes civile për komunitetin.

➤ **Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Pukë:**

Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se Bashkia Pukë gjatë vitit 2020 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

➤ **Realizimi i Investimeve:**

Titulli i gjetjes: Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli pa garantimin e fondeve për kryerjen e tyre.

Situata: Grupi i KLSH konstatoi se niveli i realizimit të investimeve të planifikuara paraqitet i ulët, ku për vitin 2020 është realizuar në masën 72%, ku nga vlera e planifikuar prej 97,867 mijë lekë është realizuar vlera 70,591 lekë me një diferencë prej 27,277 mijë lekë.

Sipas përfaqësuesve të bashkisë Pukë (Drejtoria Financë/Buxhetit), ky mos realizim vjen si pasojë e mungesës së të ardhurave të realizuara sipas periudhave ushtrimore, (një pjesë e konsiderueshme e këtij mos realizimi vjen pasi vlera e parashikuar në buxhet prej 9,970 mijë lekë, e fituar në proces gjyqësor nga Bashkia Pukë ndaj OSHEE-së, me Vendimin nr. 2037 datë 27.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit, është derdhur në llogarinë e Bashkisë Pukë në datën 19.11.2020 dhe nuk është arritur zhvillimi dhe përfundimi i procedurave të prokurimit publik brenda vitit, duke bërë që këto të ardhura të trashëgohen në vitin 2021.

Gjithashtu, investimi me objekt *“Ndërtim i parkut të aventurës”,* i planifikuar nga FSHZH në bashkëfinancim me Bashkinë Pukë (vlera e bashkëfinancimit ishte 8,000 mijë lekë) nuk filloi brenda vitit dhe për këtë arsye nuk u shpenzua pjesa e buxhetit të planifikuar për vitin 2020.

Sipas grupit të KLSH-së, kjo vjen kryesisht nga planifikimi i procedurave pa fonde në dispozicion, në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve ose planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave, të ardhurat e veta për asnjë nga vitet nuk janë realizuar, konkretisht për periudhën 2019/2020 paraqitet 45-96%, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre.

Për sa më sipër, përgjegjësia është e z. Gj. Gj., me funksion Kryetar i bashkisë Pukë dhe znj. F. P., me funksion Drejtore e drejtorisë së administrimit të përgjithshëm.

Kriteri: ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,* i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,* ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”,* i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 *“Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”,* i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”,* neni 9 pika 1.3 germa *“öç”* dhe *“çç”*; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *“Për financat e vetëqeverisjes vendore”,* nenet 2 dhe 3 pika 3; UMF nr. 9, datë 20.03.2018 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,* i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, *“Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”,* UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 *“Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”,* UMF nr. 22, datë 30.07.2018 *“Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”,* UMF nr. 23 datë 22.11.2016 *“Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”* dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Ndikimi/Efekti: Planifikimi i shpenzimeve pa siguruar burimin e tyre, i cili kryesisht vjen nga të ardhurat, mbështetja e tyre në planin e të ardhurave, çon në rritjen e nivelit të

kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

Shkaku: Planifikimi i shpenzimeve, pa një studim të mirëfilltë, duke u bazuar në raport me planin dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të sektorit të taksave dhe tarifave vendore, për asnjë nga periudhat ushtrimore të mëparshme nuk ka pasur realizim të planit të të ardhurave.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga Bashkia Pukë, të merren masa që planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar shpenzimet më të domosdoshme për nevojat e bashkisë Pukë.

➤ ***Realizimi faktik i buxheteve sipas periudhave ushtrimore***

Realizimi i buxhetit të vitit 2020, sipas burimeve të financimit, është paraqitur i përmbledhur në **Pasqyrën B10**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për të ardhurat e veta, gjatë vitit 2020 pagat dhe sigurimet shoqërore janë realizuar në nivelin 7%, shpenzimet operative në nivelin 19%, fondi i kontigjencës në nivelin 16% dhe investimet në nivelin 6%. Në total, me të ardhurat e veta, bashkia Pukë mbulon vetëm 6% të totalit të shpenzimeve.

Situacioni total i shpenzimeve të Bashkisë Pukë për vitin 2020 është paraqitur në **Pasqyrën B21**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ ***Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.***

Përsa i përket situatës së pandemisë, nga Bashkia Pukë gjatë vitit 2020 janë kryer në formën e ndihmës ekonomike 19 transaksione, në formën e ndihmës ekonomike për përballimin e nevojave ndaj situatës Covid-19, në vlerën totale 6,927,520 lekë, sipas **Pasqyrës B11**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i regjistrit të prokurimeve, u konstatuan disa blerje materiale, për shkollat, kopshtet, shërbimin social dhe familjet në nevojë, në shumën 463,896 lekë, të cilat janë sipas **Pasqyrës B12**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për përballimin e nevojave të lindura për shkak të pandemisë Covid-19, nga bashkia Pukë nuk janë bërë ndryshime të buxhetit por fondet e parashikuara në buxhet për materiale shërbimi, pastrimi dhe dezinfektimi, janë përdorur për situatën e Covid-19, me argumentin se një periudhë kohe shkollat kanë qenë të mbyllura, mësimi është zhvilluar *online* dhe institucionet kanë funksionuar me kapacitet të kufizuar. E gjithë puna për dezinfektim është kryer nga punonjësit e shërbimeve publike të bashkisë Pukë.

2.1.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shogërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.):

Titulli i gjetjes: Paraqitje e faturave në degën e thesarit pas afatit 30 ditor. Nivel i lartë i detyrimeve të prapambetura. Planifikim jo i saktë jo i plotë dhe jo në rend kronologjik për shlyerjen e këtyre detyrimeve.

Situata: Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Me fondet e vitit buxhetor 2020, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministrinë e linjës apo FZSHH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në

PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Për vitin 2020, detyrimet në fund të periudhës ushtrimore kanë qenë në shumën 59,251 mijë lekë, nga të cilat me VKB-në nr. 91, datë 27.12.2019 është parashikuar të likuidohet vlera 7,000 mijë lekë, nga të cilat 3,000 mijë lekë që i përkasin llogarisë 602 dhe 4,000 mijë lekë që i përkasin llogarive 230-231.

Nga planifikimi, konstatohet se në fund të vitit 2020, vlera e detyrimeve të planifikuara për vitin buxhetor është më e vogël, nisur nga fakti se planifikimi i buxhetit të vitit pasardhës hartohet dhe miratohet në muajin nëntor dhe detyrimet nuk kanë dalë të gjitha.

Në shumën e paplanifikuar përfshihen edhe vendimet gjyqësore të mbartura ndër vite.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës *ōDetyrimet e prapambeturaō*, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura janë paraqitur në **Pasqyrën B13**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të palikujduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të periudhave ushtrimore, rezultoi se:

Për vitin 2020, detyrimet e raportuara janë në vlerën 59,251 lekë. Sipas ditarit të bankës, urdhër shpenzimeve dhe dokumentacionit financiar shoqërues të vënë në dispozicion nga Drejtoria Ekonomike, rezultoi se gjendja e detyrimeve të palikujduara në fund të vitit 2020 është në shumën 59,251 lekë, pra me një diferencë prej 0 lekë.

Në totalin e faturave të palikujduara për vitin 2020, faturat e artikullit 602 paraqiten në shumën 5,692 mijë lekë ose 9.6% të totalit, ku shpenzimet për investime janë në shumën 43,486 mijë lekë ose 73.3% dhe shpenzimet gjyqësore janë në shumën 10,071 mijë lekë ose 17.1% e totalit.

Është i paargumentuar fakti se referuar situatës së pasqyrave financiare të vitit 2020, megjithëse në llogarinë 520 ka gjendje monetare të papërdorur, përsëri Bashkia Pukë ka detyrime kreditore të papaguara dhe në vlera të konsiderueshme. Kështu në fund të periudhës së vitit 2019 në llogarinë 520 ka pasur gjendje në vlerën 67,083,955 lekë dhe në fund të vitit 2020 llogarinë 520 paraqitet në vlerën 82,386,492 lekë. Pavarësisht se një pjesë e këtyre fondeve nuk mund të prekeshin për shkak se kanë qenë të specifikuara nga transfertat, pjesa tjetër mund të ishte përdorur për të shlyer plotësisht ose pjesërisht detyrimet e prapambetura.

Në mënyre analitike, detyrimet e prapambetura janë paraqitur në formë analitike në **Pasqyrat B14-B20**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ ***Faturat e palikuiduara***

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Pukë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2020, janë pa paguar gjithsej 16 fatura me vlerë 5,209 mijë lekë, nga të cilat 13 fatura i përkasin llogarisë 602 në vlerën 1,494 mijë lekë dhe 3 fatura i përkasin llogarive 230-231 në vlerën 3,715 lekë. Në mënyre analitike, këto fatura janë paraqitur në **Pasqyrën B14**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga Bashkia Pukë nuk ka fatura të cilat të jenë likuiduar duke kryer pagesa të pjesshme.

➤ ***Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës dhe detyrimet kontraktuale:***

Nga auditimi i dokumentacionit për detyrimet ndaj vendimeve gjyqësore, u konstatua se deri në fund të vitit 2019 paraqitet vlera totale prej 10,941 mijë lekë. Gjatë vitit 2020 është likuiduar shuma prej 2,575 mijë lekë dhe mbetet për likuidim shuma prej 10,071 mijë lekë. Më hollësisht këto të dhëna janë paraqitur në **Pasqyrën B23**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ ***Programimi i fondeve për faturat e palikujduara në fund të periudhave ushtrimore:***

Për vitin 2020 është planifikuar shlyerja e detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhës, konkretisht, në programin 1710 *ōLikujdimi i detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësoreō*, është parashikuar shlyerja e 2,000 mijë lekëve; në programin 6260 *ōDetyrimet ne zërin 602 nga të trashëguaratō*, është parashikuar shlyerja e 1,000 mijë lekëve; dhe në programin 1710 *ōInvestimeō*, është parashikuar shlyerja e 4,000 mijë lekëve.

Nga sa më sipër, konstatohet se Bashkia Pukë në planifikimin e fondeve buxhetore për likuidimin e faturave të prapambetura (kreditorët) me miratimin e buxheteve fillestare, planifikon një përqindje të ulët në raport me vlerën totale të faturave kreditore, ku për vitin 2020 nga vlera e faturave kreditore prej 59,251 mijë lekë është planifikuar vlera 7,000 mijë lekë ose 11.8%.

Mos planifikimi i vlerës së plotë të faturave, edhe pse janë me dokumentacion të rregullt, çon në trajtim me dy standarde të subjekteve, duke penalizuar disa dhe favorizuar disa të tjera dhe duke mos ndjekur radhën kronologjike të pagesës sipas periudhave për kryerjen e shërbimeve apo blerjen e mallrave që këto subjekte i kanë ofruar bashkisë Pukë, si dhe i jep mundësi padrejtësisht bashkisë që me fondet të cilat nuk planifikohen për likujdimet të këtyre faturave kreditore të planifikojë shpenzime për shërbime/blerje mallra dhe investime jo në raport të fondet, duke rritur vlerën e faturave kreditore ose thënë ndryshe borxhin që Bashkia Pukë ka ndaj subjekteve të ndryshme. Sa më sipër, kjo bashki është afër klasifikimit me vështirësi financiare, pasi stoku i detyrimeve të prapambetura paraqitet rreth 17.7% e shpenzimeve vjetore të miratuara.

Për sa më sipër, përgjegjësia është e z. Gj. Gj., me funksion Kryetar i bashkisë Pukë dhe znj. F. P., me funksion Drejtor e drejtorisë së administrimit të përgjithshëm.

Kriteri: ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 *ōPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëō*, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016 nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *ōPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollinō*; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *ōPër sistemin e taksave vendoreō*, i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 *ōPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareō*, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *ōPër vetëqeverisjen vendoreō*, neni 9 pika 1.3 germa *ōçō* dhe *ōçō*; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *ōPër financat e vetëqeverisjes vendoreō*, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *ōPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitō*, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, *ōPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020ō*; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 *ōPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendorō*, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 *ōPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njërive të vetëqeverisjes vendoreō*; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 *ōPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëmō*.

Ndikimi/Efekt: Planifikimi i shpenzimeve pa siguruar burimin e tyre, i cili kryesisht vjen nga të ardhurat, mbështetja e tyre në planin e të ardhurave, çon në rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

Shkaku: Planifikimi i shpenzimeve, pa një studim të mirëfilltë, duke u bazuar në raport me planin dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të sektorit të taksave dhe tarifave vendore, për asnjë nga periudhat ushtrimore të mëparshme nuk ka pasur realizim të planit të të ardhurave. Zhvillimi i procedurave të prokurimit jo në raport me fondet buxhetore të disponueshme.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim 1: Bashkia Pukë, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program dhe radhës së faturave, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

Rekomandim 2: Bashkia Pukë, Drejtoria Ekonomike, të marrë masa dhe të paraqesë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave dhe

detyrimeve për vendimet gjyqësore në të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **59,251 mijë lekë**, nga faturat e papaguara dhe për vlerën **10,071 mijë lekë** nga vendimet gjyqësore (në datën 31.12.2020) si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim të plotë në kontabilitet.

Rekomandim 3: Bashkia Pukë, të marrë masa që të ardhurat e pa përdorura në fund të vitit, të mos i mbartë në vitin pasardhës, por t'i përdorë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, kontraktuale dhe gjyqësore, sipas rradhës kronologjike të krijimit të tyre.

2.1.5. Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR etj, saktësia e raportimit buxhetor të tyre:

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për periudhën 2019 - 2020, në lidhje me investimet publike, u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk ka financim projektesh nga FSHZH, ndërsa nga ministritë e linjës dhe donacione, janë 5 projekte me vlerë kontrate 50,055,929 mijë lekë, nga e cila 3 projekte me vlerë 38,994,946 mijë lekë financuar në vitin 2019 dhe dy projekte me vlerë 11,060,983 mijë lekë financuar në vitin 2020, sipas detajeve të mëposhtme.

1. Rehabilitim i kanalit vaditës fshati Qerret, Bashkia Pukë, 2019, vlera 17,777,781 lekë me TVSH (vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit sipas VKM nr. 170, datë 27.03.2019 *öPër programin Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimitö*, i financuar në 2 vite kalendarike, 2019 dhe 2020 (vlera e financimit për vitin 2019 është 15,000,000 lekë);

2. Punime ndërtimi për diga/Punime ndërtimi për përforcim digash, 2019, vlera 18,846,895 lekë me TVSH (vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit sipas VKM nr. 170, datë 27.03.2019 *öPër programin Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimitö* i financuar në 2 vite kalendarike 2019 dhe 2020 (vlera e financimit për vitin 2019 është 10,000,000 lekë);

3. Punime për vendosjen e zonave të shijimit në familjet përfituese të projektit Kuzhina lokale Mali i Zi-Shqipëri, 2019, vlera 2,370,270 lekë me TVSH (vënë në dispozicion nga BE (Në zbatim të projektit ndërkufitar Shqipëri-Mali i Zi);

4. Rehabilitim i Ish-Fjetinës së N.SH.N-së, Bashkia Pukë, 2020, vlera 9,983,623 lekë me TVSH (Buxheti i Shtetit sipas shkreses nr. 13712/1 prot, data 17.07.2020 *öNë kuadër të politikave të strehimit për vitin 2020ö* i financuar në 2 vite kalendarike 2020 dhe 2021 me bashkëfinancim 20% Bashkia Pukë (vlera e financimit për vitin 2020 është 8,601,563 lekë pa tvsh (7,037,642 lekë buxheti shtetit + 1,563,921 lekë buxheti i Bashkisë);

5. Sinjalistika për rrugët gastronomike pjesë e projektit të BE Shqipëri-Mali i Zi, 2020, 1,077,360 lekë me TVSH (vënë në dispozicion nga BE (Në zbatim të projektit ndërkufitar Shqipëri-Mali i Zi).

Nga fondet e Bashkisë Pukë dhe Grantet, janë financuar **2** projekte me vlerë kontrate **40,197,480 lekë me TVSH**, nga e cila: për vitin 2019 është financuar 1 projekt me vlerë 37,151,280 lekë me TVSH dhe për vitin 2020 është financuar 1 projekt me vlerë 3,046,200 lekë me TVSH, konkretisht;

- Rikonstrukcion rruga Lagjia Kukaj, Bashkia Pukë, 2019 37,151,280 lekë me TVSH
- Rikonstrukcion rruga Krovë, Blinisht, 2020 3,046,200 lekë me TVSH

Kontratat nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara por në periudha të mëvonshme, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve nga FZHS/Ministritë e linjës dhe për pjesën e Bashkisë Pukë nga mos realizmi i të ardhurave nga taksat/tarifat vendore, të dhëna të cilat paraqiten, si vijon:

- **Për financimet nga Ministritë e linjës dhe donatorë të tjerë:** Janë lidhur për vitin 2020 gjithsej 2 kontrata në vlerën 11,061 mijë lekë. Financuar me vonesë vlera 1077 mijë lekë, nga e cila: financuar në vitin 2021 vlera 1,077 mijë lekë, është e pa likuiduar vlera prej 2,382 mijë lekë, pasi akoma nuk ka përfunduar procedura për marrjen në dorëzim të objektit

oRehabilitim i Ish-Fjetines së N.SH.N-sëo.

- **Për financimet nga buxheti Bashkisë Pukë dhe Grante:** Për vitin 2020 është lidhur gjithsej 1 kontratë në vlerën 3,046 mijë lekë, e cila është financuar brenda afateve.

- **Për kontratat e lidhura në vitin 2019 në vlerën 37,151 mijë lekë:** Janë financuar në dy vite, konkretisht gjatë vitit 2020 është financuar 1 kontratë me vlerë 16,503 mijë lekë dhe në vitin 2021 është financuar vlera prej 20 648 mijë lekë. Kontrata është likuiduar totalisht.

- **Për kontratat e periudhës 2019 me fondet e viteve 2019 dhe 2020, në vlerën 36,625 mijë lekë:** Janë lidhur gjithsej 2 kontrata me vlerë 36,625 mijë lekë dhe janë bërë likudimet në dy vite sipas çeljeve të bëra nga Ministria e Linjës. Kontratat janë likuiduar totalisht.

Për vitin 2020, nga transferta specifike, fondet në shumën 8,547 mijë lekë për objektin oRehabilitim i Kanalit vaditës fshati Qerret Bashkia Pukëo dhe 18,847 mijë lekë për objektin oPunime ndërtimi për diga/Punime ndërtimi për përforsim digasho janë mbartur nga vitit 2019 dhe janë akorduar për vitin 2020. Për objektin oPunime ndërtimi për diga/Punime ndërtimi për përforsim digasho, Urdhri i prokurimit është nxjerrë në vitin 2019, por lidhja e kontratës është bërë në janar 2020 dhe likuidimi brenda vitit 2020.

Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Pukë dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas planifikimit në PBA. Nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara me qëllim pagesën e saj dhe në rastet kur fondi nga Ministria ka ardhur i ndarë në afate mujore kontrata është regjistruar e plotë, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

➤ **Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor dhe përdorimi i tyre:**

Për vitin 2020, të ardhurat nga 42,408 mijë lekë të planifikuara, janë arkëtuar në vlerën 40,787 mijë lekë ose 96 %, me një diferencë prej 1,621 mijë lekë;

Me të ardhurat e veta, për vitin 2020 bashkia ka mbuluar 10% të totalit të shpenzimeve.

Evidenca e realizimit të të ardhurave për periudhën 01.01.2020 deri 31.12.2020, është paraqitur në **Pasqyrën B24**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ **Auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020)**

Për vitin 2019, pagat dhe organika janë miratuar me VKB nr. 90, datë 24.12.2018 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara - 2019”, konfirmuar nga Prefekti Shkodër me shkresën nr. 11/1 prot, datë 15.01.2019.

Për vitin 2020, pagat dhe organika janë miratuar me VKB nr. 79, datë 27.12.2019 “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të Deleguara - 2020”, konfirmuar nga Prefekti Shkodër me shkresën nr. 29/1 prot, datë 13.01.2020.

Numri i punonjësve dhe fondet e pagave dhe sigurimeve, për vitet 2019 dhe 2020, është paraqitur në **Pasqyrën B25**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nuk u konstatua tejkalim i numrit të punonjësve të miratuar me VKB, konstatuar kjo nga auditimi i listëpagesave të periudhave Janar ó Dhjetor 2020.

Të dhënat mbi largimet dhe emërimet e punonjësve nga puna janë paraqitur në **Pasqyrën B26**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

U konstatua se Aktet e emërimit në pozicione pune të punonjësve me status të Nënpunësit civil, janë në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013, datë 30/05/2013 oPër Statusin e Nënpunësit Civilo i ndryshuar dhe Kreut II, IV dhe VI të VKM nr. 243, datë 18.3.2015.

Mbulimi me fonde i pagave të punonjësve sipas periudhave është paraqitur në **Pasqyrën B27**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga të dhënat e pasqyrës, për vitin 2019 konstatohet se me fondet e veta Bashkia Pukë mbulon 3% të fondit të pagave, ndërsa diferenca mbulohet me grandet e ardhura nga Pushteti Qendror.

Nga të dhënat e pasqyrës, për vitin 2020 konstatohet se me fondet e veta Bashkia Pukë mbulon 7.3% të fondit të pagave, ndërsa diferenca mbulohet me grandet e ardhura nga Pushteti Qendror.

2.2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

➤ *Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*

Në Bashkinë Pukë, për vitin 2020, numri i përgjithshëm i punonjësve dhe niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 79, datë 27.12.2019, me ndryshime dhe me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 162, datë 07.07.2020, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së zhvillimit ekonomik, në përbërje të së cilës është Sektori i taksave dhe tarifave vendore.

Ky Sektor ka në përbërje 6 punonjës, nga të cilët 1 përgjegjës sektori dhe 5 specialistë. Specialistët janë të ndarë në secilën nga njësitë administrative, sipas detyrave të përcaktuara në Rregulloren e institucionit. Aktualisht, tre specialistë janë me kontratë pune dhe në procedurë për përfitimin e statusit të nëpunësit civil.

Struktura e Sektorit të taksave dhe tarifave vendore është paraqitur në **Pasqyrën A1**, në Aneksat bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi, u konstatua se nga data 31.10.2019, deri në datën 30.06.2020 zyra e tatim-taksave në Bashkinë Pukë ka funksionuar pa përgjegjës, gjë që ka ndikuar në mosfunksionimin e plotë dhe në krijimin e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore.

Këshilli Bashkiak Pukë, ka vendosur me VKB-në *ËPër sistemin e taksave dhe tarifave vendore* afatin e fundit të pagesës së detyrimit datën 20 shtator të çdo viti për biznesin e vogël, 30 shtator për biznesin e madh dhe 31 maj për institucionet.

➤ *Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve*

Titulli i gjetjes: Performancë e dobët në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave për periudhën objekt auditimi.

Situata: Për vitin 2019, paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pukë është miratuar me VKB-në nr. 89, datë 24.12.2018, e konfirmuar nga Prefekti Shkodër me shkresën nr. 10/1, datë 16.01.2019, ndërsa për vitin 2020, paketa e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB-në nr. 80, datë 27.12.2019, e konfirmuar nga Prefekti Shkodër me shkresën nr. 30/1, datë 13.01.2020, *ËPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Pukë*.

Referuar planit vjetor të miratuar dhe aktrakordimit me Degën e Thesarit Pukë parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitet 2019 dhe 2020 është paraqitur në **Pasqyrën A2**, në Aneksat bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga të dhënat e **Pasqyrës A2**, konstatohet se *për vitin 2019*, të ardhurat nga 44,031 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 19,969 mijë lekë ose 45%, pra me një mosrealizim në shumën 24,062 mijë lekë. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga defiçiti i krijuar nga pandemia Covid-19, ndërsa *për vitin 2020*, të ardhurat nga 42,408 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 40,787 mijë lekë 96%. Në planifikimin e të ardhurave konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve të familjarëve, përfshirë taksën e tokës, nuk është përlllogaritur, pra planifikimi i të ardhurave është bërë me rezervë.

Përveç taksës vendore për biznesin e vogël, e cila ka lidhje me mënyrën e parashikimit, pjesën kryesore të mosrealizimit e zënë taksat e familjarëve, siç është taksat e ndërtesës, taksat e tokës dhe disa tarifa shërbimesh, kryesisht për popullatën.

Për vitet 2019 dhe 2020, evidencat e rakordimeve me thesarin janë nënshkruar nga: z./znj. F. P., në cilësinë e drejtorit të financës, z./znj. P. V., në cilësinë e Përgjegjës të degës së Thesarit Pukë dhe z. Gj. Gj. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë.

Referuar **Pasqyrës A2**, konstatohet se për disa taksa dhe tarifa, realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve, e cila kryesisht vjen për shkak të mosnjohjes së situatës dhe moskryerjes së rregullt të procedurave, i cili ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Pukë, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj, në dëm të interesave të publikut.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

Z. Gj. Gj., me detyrë Kryetar i bashkisë Pukë;

Z. N. A., me detyrë Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave vendore.

Kriteri:Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, *ËPër vetëqeverisjen vendore*, neni 64, *ËKompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë*; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 *ËPër Financat e Vetëqeverisjes Vendore* i ndryshuar, neni 5, *ËParime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore*, neni 42, *ËAdministrimi i mjeteve monetare*, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, *ËRaportimi financiar* nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV *ËProcedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave* pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *ËPër Sistemin e Taksave Vendore*, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 *ËPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti:Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave shkakton mangësi dhe probleme në likuidimin e shpenzimeve të kryera nga institucioni, si dhe është shkak kryesor për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Shkaku:Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim:Bashkia Pukë, gjatë hartimit të projekt/planit të buxhetit, të planifikojë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e degës së thesarit sipas akt-rakordimeve të financës, buxhetit dhe kontabilitetit.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitore nga veprimtaritë e ndryshme dhe përdorimi i aseteve të Bashkisë Pukë:**

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga dhënia me qera e aseteve të Bashkisë, si troje, toka bujqësore, pyje e kullota.

Situata:Nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në zyrën e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Pukë, u konstatua se për vitin 2020 ka pasur gjithsej 38 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 441,524 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 2 subjekte, në vlerën 19,008 lekë, konkretisht A. B. dhe N. M. në

vlerën 9,504 lekë secili. Vlera **19,008 lekë** përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Krahas hapësirave publike, Bashkia Pukë ka lidhur 17 kontrata me subjekte juridike, me afat nga 1 deri në 35 vjet, nga të cilët është pa likuiduar vlera totale prej 7,448,956 lekë, e cila përbën mungesë të ardhurash për Bashkinë Pukë. Nga kjo vlerë, subjekti E. U. shpk ka shlyer detyrimin gjatë vitit 2021. Rrjedhimisht, vlera debitore në fund të vitit 2020 ngelet **6,351,472 lekë**.

Kontratat, pagesat dhe vlera e debisë nga asetet e dhëna me qera për vitin 2020, janë paraqitur në **Pasqyrën A3**, në Aneksat bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga bashkia Pukë nuk janë llogaritur kamatëvonesat për secilin rast, në kundërshtim me nenin 5 *oLlogaritja e kamatëvonesës*, të ligjit nr. 48/2014 *oPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

Z. Gj. Gj., me detyrë Kryetar i Bashkisë Pukë;

Z. N. A., me detyrë Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave vendore.

Kriteri: Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 *oKodi Civil i Republikës së Shqipërisë* i ndryshuar; Ligji nr. 48/2014 *oPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*; Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 *oPër tokën*, i ndryshuar; Ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 *oPër tokat bujqësore të pandara*, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 *oPër tokat bujqësore të pandara*, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, *oPër përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për t'u lidhur me qeramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 *oPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 *oPër procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*, etj.

Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në buxhetin e Bashkisë Pukë në vlerën **6,370,480 lekë** (6,351,472+19,008).

Shkaku: Mosndjekja e procedurave nga strukturat përgjegjëse. Mangësi në përcaktimin specifik të detyrave dhe mungesë e personelit përgjegjës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Pukë të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar (përfshirë vlerën e kamatëvonesave) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **6,370,480 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se taksa e ndikimit në infrastrukturë, për vitin 2020 është realizuar në shumën 889,000 lekë nga 1,319,000 lekë të planifikuara ose në masën 67%.

Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2019 janë dhënë 17 leje legalizimi për 2,670.6 m² ndërtim, me vlerë investimi prej 87,782,622 lekë, në vlerën e taksës prej 438,913 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 136,050 lekë, duke mbetur pa shlyer 10 posedues të lejeve të legalizimit të një sipërfaqeje prej 1,842.8 m² me vlerë **302,863 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2020 janë dhënë 12 leje legalizimi për 1,042.7 m² ndërtim, me vlerë investimi prej 34,273,549 lekë, në vlerën e taksës prej 171,368 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 96,836 lekë, duke mbetur pa shlyer 4 posedues të lejeve të

legalizimit të një sipërfaqeje prej 453.5 m² me vlerë **74,532 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Numri i lejeve të legalizimit, sipërfaqja dhe vlera e TNI është paraqitur në **Pasqyrën A4**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitet 2019 dhe 2020 janë paraqitur në **Pasqyrën A5**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Të dhënat për arkëtimet nga lejet e ndërtimit dhe aplikimet e ndryshme për leje/deklarata ndërtimi, për vitet 2019-2020 janë paraqitur në **Pasqyrën A6**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

Z. Gj. Gj., me detyrë Kryetar i Bashkisë Pukë;

Z. N. A., me detyrë Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave vendore.

Kriteri: Ligji nr. 9482 datë 03.04.20106, *ōPër legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeō* i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, *ōPër sistemin e taksave vendoreō*, i ndryshuar; VKB Pukë *ōPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Pukëō*, etj.

Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në vlerën **377,396 lekë**, nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit nga përfituesite lejes së legalizimit.

Shkaku: Mos bashkëpunimi i fortë me ASHK-në dhe mosmarrja e masave të duhura për parandalimin e dhënies së lejeve të legalizimit pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë pranë Bashkisë Pukë nga subjektet private dhe individët për objektet në proces legalizimi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Pukë nëpërmjet bashkëpunimit institucional tō kërkojë ASHK-së, Drejtoria Shkodër, që të mos lëshojë dhe të pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Pukë. Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe administrimit të territorit, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e listuar si debitorë në Pasqyrën A5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, bazuar në legjislacionin tatimor.

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Për qytetin dhe çdo njësi administrative është krijuar në mënyrë manuale dhe elektronike regjistri për taksat dhe tarifave vendore për subjektet private dhe familjarët, si më poshtë:

1. Regjistri Elektronik për Bizneset në formatin Excel.
2. Regjistri Elektronik për taksën e Tokës në formatin Excel.
3. Regjistri Elektronik për Popullatën në formatin Excel.

Gjithashtu, regjistrat janë hartuar dhe funksionojnë edhe në formë manuale, konform me formatin përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Pukë janë paraqitur në **Pasqyrën A7**, bazuar në legjislacionin tatimor.

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore.**

Titulli i gjetjes: Mangësi në evidentimin dhe vlerësimin e nivelit të detyrimeve debitore, kontabilizimet dhe procedurat e ndjekjes së borxhit tatimor për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Pukë.

Situata: **Niveli i lartë e debitorëve.** Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga zyra e tatim-taksave vendore në Bashkinë Pukë, rezultoi se ka 90 subjekte debitore nga biznesi. Numri i debitorëve nga biznesi në numër dhe në vlerë (për taksat dhe tarifave vendore), krahasuar me vitin 2019 është ulur, nga 106 në 90 biznese, ndërsa vlera debitore ka ardhur duke u rritur, nga

10,080,960 lekë që ishte në fund të vitit 2019 ka shkuar në 14,909,764 lekë në fund të vitit 2020. Vlera prej **14,909,764 lekë** përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë Pukë. Vlera e debitorëve e ndarë sipas viteve, numrit dhe sipas biznesit, në mënyrë të përmbledhur është paraqitur në **Pasqyrën A8**, në Aneksat bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vlera e debitorëve e ndarë në vlerë principali plus kamatëvonesëe përlllogaritur (0,06 % për çdo ditë vonesë) dhe numrit të subjekteve është paraqitur në **Pasqyrën A9**, në Aneksat bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Numri i subjekteve dhe vlera e debitorëve gjendje në fund të vitit ushtrimor e ndarë sipas NJA dhe institucioneve, është paraqitur në **Pasqyrën A10**, në Aneksat bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Subjektet debitore, me vlerat e debisë dhe kamatëvonesat përkatëse janë paraqitur në **Pasqyrën A11**, në anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për vitin 2019 janë bërë 85 njoftim detyrimi dhe janë lëshuar 40 urdhër bllokime, ndërsa për vitin 2020 janë bërë 89 njoftim detyrimi, janë lëshuar 75 urdhër bllokime, si dhe 37 kërkesa për vendosjen e bllokimeve hipotekore.

Sa më sipër, nuk gjen zbatim ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, *ËPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, neni 89 *ËNjoftimi dhe kërkesa për të paguar*.

Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore, strukturat tatimore të Bashkisë Pukë, nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 *ËPër Procedurat Tatimore*, me ndryshime, Kreut XI, *ËMbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*, neni 93 dhe 94.

Gjithashtu nga strukturat tatimore të Bashkisë Pukë, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në nenin 181, *ËMos pagimi i taksave dhe tatimeve*, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore*, i ndryshuar neni 9 *ËTë drejtat dhe përgjegjësitë* pika 1.3.

Neni 35, *ËTë ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*, me ligjin nr. 68/2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore* i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 *ËPër sistemin e taksave vendore*, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

Z. Gj. Gj., me detyrë Kryetar i Bashkisë Pukë;

Z. N. A., me detyrë Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave vendore.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore* i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore* i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 *ËPër sistemin e taksave vendore*, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 *ËPër Procedurat Tatimore*, me ndryshime, Kreut XI, *ËMbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 *ËKodi Penal i RSH* me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore*, i ndryshuar neni 9 *ËTë drejtat dhe përgjegjësitë* pika 1.3., neni 35, *ËTë ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*, me ligjin nr. 68/2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore* i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 *ËPër sistemin e taksave vendore*, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Ndikimi/Efekti: Krijimi i një numri të madh debitorësh në vlera të konsiderueshme. Efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Pukë, duke shkaktuar mosrealizim të shpenzimeve dhe krijim të detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Mos marrja e masave të plota për ndjekjen e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Bashkia Pukë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj **90 subjekteve** debitore në vlerën prej **14,909,764 lekë** (sipas *Pasqyrave në Aneksat e Raportit Përfundimtar të Auditimit*), duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Pukë, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Titulli i gjetjes: Krijimi i debitorëve dhe mosndjekja nga agjenti tatimor Ujësjiellës Kanalizime sha Pukë. Lënia jashtë skemës së taksimit të abonentëve familjarë pa kontrata me ujësjiellësin, për Njësitë Administrative Gjegjan, Qerret dhe Rrapë. Probleme me vjeljen e taksës së tokës bujqësore. Mbi procedurat e ndjekura të arkëtimit të taksës së ndërtesës dhe tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit nga abonentët familjarë.

Situata:

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:**

Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimit nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta. Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë MFE në lidhje me rentën minerare; ASHK-ja në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë; DRSHTRR Shkodër në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Pukë dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Pukë.

Në lidhje me subjektet, detyrimet tatimore të të cilëve arkëtohen nga agjentët tatimorë, u konstatua se nga Bashkia Pukë nuk është krijuar një bazë e dhënash e plotë dhe e saktë, ku të përcaktohet numri i subjekteve tatimpagues, lloji i detyrimeve të tyre, periudha e ushtrimit të veprimtarisë, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa subjekte janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, si dhe nuk është bërë asnjëherë rakordim me këta agjentë në lidhje me detyrimet e tyre ndaj Bashkisë Pukë, pavarësisht konfirmimit të arkëtimit nga dega e thesarit Pukë.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë janë paraqitur në **Pasqyrën A12**, në Aneksat bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në lidhje me tarifën që duhet të mbledhë agjenti tatimor Ujësjiellës-Kanalizime Pukë Sh.A., konstatohet se akt-rakordimet nuk janë mbajtur në rregull çdo muaj, por mbahen një herë në vit. Për vlerat e paarkëtuara nga subjektet dhe popullata debitore nuk janë zbatuar përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”,* i

ndryshuar, neni 117 *ōDēnimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave*, pika b).

➤ **Detyrimet e familjarëve:**

- *Mēnyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve*

Për njësinë administrative Qendër Pukë (Bashkia) detyrimet e familjarëve janë parashikuar mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë me Ndërmarrjen e Ujësjetllës Kanalizimeve Pukë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, kryesisht në bazë të kërkesave të individëve për marrjen e shërbimeve nga zyra e shërbimeve, zyra me një ndalesë etj., pranë bashkisë Pukë, informacioneve nga zyrat e shërbimeve sociale për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe familjet me statusin paraplegjik dhe tetraplegjik, duke bërë përjashtimet përkatëse sipas Ligjit nr. 9632/2006 *ōPër sistemin e taksave vendore*, i ndryshuar, evidencave të të punësuarve në institucionet shtetërore dhe private, pas verifikimit me zyrat e Gjendjes Civile, informacioneve verbale të siguruara nga OSHEE, nëpërmjet kontratave të energjisë elektrike, etj.

- *Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese*

Abonentët familjarë të cilët kanë kontratë furnizimi me agjentin tatimor (Ndërmarrja e Ujësjetllës Kanalizimeve Pukë), lidhur me detyrimet për taksën familjare njoftohen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm, ku shënohen të gjitha taksat dhe tarifatat e abonentëve. Zyra e tatimeve dërgon çdo muaj listën e abonentëve familjarë dhe llogaritjen e taksës/tarifës përkatëse për çdo abonent familjar. Për abonentët familjarë të cilët nuk paguajnë detyrimet vendore, si masë shtrënguese, zyrat pranë bashkisë, nuk u ofrojnë kryesisht shërbimet administrative ndaj tyre deri në likuidimin e detyrimeve.

Në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifatat vendore, sipas njësive administrative.

Numri i familjeve dhe pagesat e bëra janë paraqitur në **Pasqyrën A13**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Nga 5,249 familje, paguajnë vetëm 884 familje.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga familjarët për NJ. A. Pukë, 2020 është paraqitur në **Pasqyrën A14**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në total, nga taksat dhe tarifatat e popullatës është realizuar 78% e planifikimit.

Planifikimi i taksave të familjarëve për Nj. A. Pukë janë paraqitur në **Pasqyrën A15**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Nga 5,249 familje, për vitin 2020 janë planifikuar për pagesë të taksave dhe tarifave vetëm 769 familje, nga 864 të planifikuara në vitin 2019.

Familjet që nuk kanë paguar detyrimet, Nj. A. Pukë janë paraqitur në **Pasqyrën A16**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për vitin 2019 nuk kanë paguar 397 familje, ndërsa për vitin 2020 nuk kanë paguar 490 familje, për një vlerë totale prej 1,001,460 lekë.

Familjet që përjashtohen nga tarifa e pastrimit me VKB janë paraqitur në **Pasqyrën A17**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe vlera prej **211,860 lekë**, e cila vjen nga diferenca e familjeve që nuk paguajnë me familjet e përjashtuara me VKB nga pagesa e detyrimeve, përbën të ardhura të munguara për bashkinë Pukë, nga mosarkëtimi i taksave të familjarëve nëpërmjet agjentit tatimor Ujësjetllës Kanalizimeve Puka Sh.A.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga familjarët për NJ. A. Gjegan, 2020 është paraqitur në **Pasqyrën A18**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga familjarët për NJ. A. Qelëz, 2020 është paraqitur në **Pasqyrën A19**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga familjarët për NJ. A. Qerret, 2020 është paraqitur në **Pasqyrën A20**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga familjarët për NJ. A. Rrapë, 2020 është paraqitur në **Pasqyrën A21**, në Aneksët bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, të cilat janë të përjashtuara nga pagesa e taksave dhe tarifave vendore, janë paraqitur në **Pasqyrën A22**, në Aneksët bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Numri i familjeve sipas regjistrit të gjendjes civile dhe faturimet përkatëse janë paraqitur në **Pasqyrën A23**, në Aneksët bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Bashkia Pukë, ka planifikuar tarifë ndriçimi vetëm për familjet të cilat jetojnë në apartamente, në qytet, ku ofrohet ky shërbim, ndërsa për familjet të cilat banojnë në lagjet periferikë të qytetit Pukë dhe familjet të cilat banojnë në fshatra, tarifa e ndriçimit nuk vilet, pasi nuk ofrohet shërbimi i ndriçimit nga ana e bashkisë. Gjithashtu, me VKB nga tarifa e pastrimit përjashtohen të verbërit, invalidët, paraplegjikët dhe tetraplegjikët.

Vlera prej **211,860 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë, nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave të familjarëve të Nj. A. Pukë për vitet 2019 dhe 2020.

Vlera prej **673,946 lekë**, nga shuma e të ardhurave të planifikuara por të paarkëtuara nga Nj. A. Gjegan, Qerret, Rrapë dhe Qelëz, për vitin 2020, përbën përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Këto vlera debie janë të pakontabilizuara sipas personave debitorë.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se nga zyra e tatim-taksave në Bashkinë Pukë nuk është llogaritur dhe nuk është faturuar vlera e planifikuar por e paarkëtuar e taksave dhe tarifave të familjarëve për periudhat para vitit 2019 për Nj. A. Pukë dhe para vitit 2020 për Nj. A. të tjera. këto vlera të planifikuara, por të paarkëtuara përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Pukë.

➤ **Taksa e tokës:**

Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 *ËPër tokën*, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 5,313 familje, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës por nuk është arkëtuar, nuk është faturuar dhe taksapaguesve nuk u është dërguar njoftim për pagesën e detyrimit. Vetëm nga Nj. A. Pukë, e cila ka edhe numrin më të vogël të familjeve të trajtuara me tokë bujqësore, kanë paguar pothuajse gjysma e familjarëve, kryesisht ata të cilët janë paraqitur në zyrat e Bashkisë për probleme të ndryshme administrative dhe u është kërkuar kryerja e pagesës në këmbim të marrjes së shërbimit. Për periudhën 2015-2020, nga auditimi rezultoi vlera debitorë **4,597,864 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë. Kjo vlerë debitorë është e pakontabilizuar. Taksa e tokës për njësinë administrative Pukë është 700 lek/ha, ndërsa për njësitë e tjera administrative, është 500 lek/ha.

Numri i familjeve përfituese dhe sipërfaqja e tokës së ndarë është paraqitur në **Pasqyrën A24**, në Aneksët bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Regjistrat e familjeve fermere, duhet të ishin përditësuar sipas të dhënave që duhet të disponojë ZAMT në Bashki, nga ZAMT në Qark apo nga ASHK Pukë për numrin e familjeve që kanë përfituar tokë në bazë të ligjit për ndarjen e tokës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 *ËPër sistemin e taksave vendore*, i ndryshuar, nenet 23 dhe 24.

Detyrimet për taksën e tokës janë paraqitur në **Pasqyrën A25**, në Aneksët bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

Z. Gj. Gj., me detyrë Kryetar i Bashkisë Pukë;

Z. N. A., me detyrë Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave vendore.

Kriteri: ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 *ËPër sistemin e taksave vendore*, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 *ËPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligji nr. 139/2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore* i

ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligji nr. 68/2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore* i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, *ËPër Taksat Kombëtare*, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, *ËPër Taksat Kombëtare*, etj.

Ndikimi/Efekt: Kanë ndikuar në nivelin e të ardhurave në **vlerën debitore prej 4,597,864 lekë**, nga mospagesa e taksës së tokës bujqësore, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Pukë. Kanë ndikuar në nivelin e të ardhurave për taksat e tarifa vendore në **vlerën debitore prej 885,806 lekë**, nga mospagesa e taksave dhe tarifave vendore, si ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Pukë.

Shkaku: Kanë munguar të dhënat nga Administratorët e Njësive Administrative se bashku me Kryetarët e Fshatrave, të cilët nuk kanë evidentuar familjet që janë trajtuar me tokë dhe familjet që nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, duke mos përditësuar listat e familjarëve që duhet të paguajnë taksat. Nga UK sha nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës debitore si dhe nga bashkia Pukë nuk është marrë masë për gjobitjen prej 50% të vlerës së paarkëtuar të agjentit tatimor UK sha.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim 1: Bashkia Pukë, të ngrëjë grup pune me specialistë të fushës, për të hartuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Pukë dhe Qarku Shkodër). Për familjet fermerë debitorë të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën **4,597,864 lekë** dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.

Rekomandim 2: Bashkia Pukë, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerave debitorë. Gjithashtu Bashkia Pukë të bashkëpunojë me ËUjësjellës Kanalizime Pukaë Sh.A. për arkëtimin e vlerës debitorë prej **885,806 lekë** dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative këtij agjenti tatimor.

Rekomandim 3: Bashkia Pukë, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifave apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Pukë, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

➤ ***Pajisja me NUIS sekondare e Operatorëve Ekonomikë të cilët kryejnë veprimtari biznesi në Bashkinë Pukë.***

Titulli i gjetjes: Mbi procedurat e kryera për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e pastrim-gjelbërim-ndriçimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në bazë të lejeve të ndërtimit dhe për subjektet të cilët kanë zbatuar kontratat e investimeve me fonde publike në territorin e Bashkisë Pukë.

Situata: Nga Sektori i zhvillimit ekonomik (Tatim-Taksa) Bashkia Pukë, nuk është vepruar për të ngarkuar me detyrime, faturuar apo për të nxjerrë njoftim detyrim për taksat dhe tarifave vendore për subjektet e pajisur me leje ndërtimi dhe për OE të cilët zbatojnë kontratat e investimeve në Bashkinë Pukë.

Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Sektori i tatim-taksave vendore, konstatohet se për

periudhën objekt auditimi, nga subjektet që kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit, të pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Pukë, 8 prej tyre nuk kanë paguar detyrimet vendore në vlerën totale **260,000 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Pukë ndërsa për 4 subjekte nuk ka informacion.

Operatorët ekonomikë të cilët kanë kryer veprimtari biznesi në bashkinë Pukë për llogari të investitorëve të ndryshëm, të cilët nuk e kanë adresën kryesore të biznesit në bashkinë Pukë dhe detyrimet e tyre janë paraqitur në **Pasqyrën A26**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vlera prej **260,000 lekë** (240,000 lekë tarifë pastrimi dhe 20,000 lekë tarifë ndriçimi) përbën të ardhura të munguara nga mosllogaritja e detyrimeve vendore për shoqëritë të cilat kanë zhvilluar veprimtari ndërtimore për llogari të institucioneve dhe individëve në bashkinë Pukë, por që nuk janë pajisur me NUIS-e për adresat sekondare dhe nuk kanë paguar detyrimet vendore.

Nga auditimi, u konstatua se këta OE, nuk kanë hapur adresa sekondare për zhvillimin e biznesit, në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore”* neni 40, *“Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare”*, pika 1, neni 43 *“Përditësimi i të dhënave të regjistrimit”* pika 1/1 dhe ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 *“Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”*, i ndryshuar, neni 22, *“Detyrimi për regjistrim”*, pika 4.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

Z. Gj. Gj., me detyrë Kryetar i Bashkisë Pukë;

Z. N. A., me detyrë Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave vendore.

Kriteri: Këto procedura të ndjekura janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore”* neni 40, *“Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare”*, pika 1, neni 43 *“Përditësimi i të dhënave të regjistrimit”* pika 1/1 dhe ligji nr. 9723 dt.03.05.2007 *“Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”*, i ndryshuar, neni 22, *“Detyrimi për regjistrim”*, pika 4; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2010 *“Për sistemin e taksave vendore”*, i ndryshuar; me ligjin nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”* i ndryshuar, me ligjin nr. 68/2017 *“Për financat e vetëqeverisjes vendore”* i ndryshuar, VKB, etj.

Ndikimi/Efekt: Efekt negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore në vlerën totale **260,000 lekë** nga mos faturimi dhe arkëtimi i taksave dhe tatimeve vendore.

Shkaku: Mos marrja e masave të plota për ndjekjen e arkëtimit e të ardhurave nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Pukë të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruarra për vitet 2019-2020, pavarësisht nëse kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Pukë dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, si dhe të nxjerrin njoftim detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore. Sipas listimit në Anekse, Pasqyra A26 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të ndjekin të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimitin e vlerës prej **260,000 lekë** nga këto detyrime vendore.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Titulli i gjetjes: Parregullsi në procedurat e kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve/Liçencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Bashkia Pukë.

Situata: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Pukë ushtrojnë aktivitetin 3 subjekte të cilat tregtojnë hidrokarbure, karburante. Subjekte të liçencuar për tregtimin e lëndëve djegëse nuk ka. Aktualisht, detyrimet për pajisjen me autorizim i ka shlyer vetëm K. Shpk, ndërsa S. Shpk dhe N. O. Shpk vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet të papajisur me autorizimin përkatës.

Nga zyra e tatim-taksave vendore në Bashkinë Pukë, informohemi se:

1. Subjekti òK.ò Shpk, ka kryer pagesat e duhura për liçencën e tregtimit të karburanteve, por jo për gazin e lëngshëm dhe rrjedhimisht është debitor për vlerën 100,000 lekë.
2. Subjekti òS.ò Shpk, ka aplikuar dhe paraqitur dokumentacion, por dokumentacioni nuk është i plotë dhe vazhdon aktivitetin pa liçencë. Ky subjekt është debitor për vlerën e papaguar 1,100,000 lekë.
3. Subjekti òN. O.ò Shpk, i cili ushtron aktivitet në njësinë Administrative Gjegjan, Bashkia Pukë nuk disponon informacion. Ky subjekt është debitor për vlerën e papaguar 1,100,000 lekë.

Pagesat e kryera deri në momentin e auditimit dhe vlerat debitoare janë paraqitur në në **Pasqyrën A27**, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vlera e papaguar prej **2,300,000 lekë**, përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Sa më sipër, është në kundërshtim me VKM-në Nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 970, datë 2.12.2015.

Përgjegjës kryesor për mosvjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave është Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, z. Gj. Gj., për moszbatimin e kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 *òPër financat e vetëqeverisjes vendore*, neni 42 *òAdministrimi i mjeteve monetare*, pika 2.

Për periudhën 30.06.2020 deri në fund të vitit 2020, përgjegjësi mban edhe përgjegjësi i zyrës vendore të tatim-taksave, z. N. A..

Kriteri: VKM nr. 970, datë 2.12.2015 *òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë* i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa òbö, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në **vlerën 2,100,000 lekë** nga mospagesa e tarifës së plotë apo të një pjese të tarifës së liçencës/autorizimit nga subjektet që ushtrojnë aktivitetin e shitjes me pakicë të hidrokarbureve pa rinovuar liçencën e tregtimit.

Shkaku: Mos ndjekja e procedurave në bashkëpunim me institucionet përkatëse për mbylljen e aktivitetit të subjekteve që nuk rinovojnë liçencën.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga Bashkia Pukë, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojnë tarifën e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **2,300,000 lekë**, sipas Anekseve bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Pasqyra A27. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Komente dhe sqarime:

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1990/13, datë 23.12.2021, protokolluar në KLSH me nr. 1111/3, datë 28.12.2021, janë përcjellë kundërshtitë për Projektraportin e Auditimit të ushtruar në Bashkinë Pukë, nënshkruar nga z. N. A. në cilësinë e Përgjegjës të sektorit të taksave dhe tatimeve vendore në Bashkinë Pukë dhe nga znj. F. P., Drejtore e drejtorisë së administrimit të përgjithshëm, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues. Këto kundërshtitë janë dërguar edhe në formë elektronike, me e-mail, në adresën jovanplaku@gmail.com, në datën 23.12.2021, ora 9:56 AM.

Shënim:

Në këtë sqarim të kundërshtive të paraqitura nga subjekti i audituar "Bashkia Pukë", me qëllim praktikitetin dhe mospërsëritjen e komenteve, fakteve dhe rrethanave të përmendura në Projektraportin e Auditimit, si dhe të bazës ligjore të përdorur, është paraqitur vetëm thelbi i kundërshtive, në formë të përmbledhur. Kundërshtitë

janë pjesë e dosjes së auditimit në formë fizike, me nënshkrimet origjinale të personave të atakuar.

Grupi i auditimit, pasi i lexoi me shumë kujdes këto kundërshti, pa anshmëri, me gjykim dhe skepticizëm profesional, thekson se do të marrë në konsideratë vetëm shpjegimet të cilat janë shoqëruar me dokumente dhe argumente ligjore shtesë, si dhe me prova të reja shkresore të cilat kanë mbështetje ligjore, ndërsa ato shpjegime të cilat nuk gjejnë argumente, por janë vetëm justifikuese, nuk do të merren në konsideratë dhe do të trajtohen përsëri në këtë Projekt Raport të Auditimit.

Pretendimi i subjektit:

1. Në Projektraportin e Auditimit, fq. 24 dhe 25, lidhur me arkëtimin e vlerave debitoare nga përdorimi i aseteve (kontratat e qirave) sqarojmë si më poshtë vijon:zyra e tatimeve vendore pranë bashkisë Pukë ka njoftuar të gjithë subjektet debitor në mënyrë të vazhdueshme, lidhur me afatet e likuidimit, vlerat përkatëse për likuidimin e detyrimit tarifë qeraje si dhe taksat tjera vendore... Vlerat debitoare nga veprimtaritë e ndryshme dhe përdorimi i aseteve janë kontabilizuar dhe reflektuar në bilancin e të ardhurave vendore... etj.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Në Projektraportin e Auditimit është specifikuar vlera debitoare dhe nuk është atakuar zbatimi i masave shtrënguese në lidhje me vjeljen e këtyre detyrimeve. Rekomandimi ka të bëjë me marrjen e masave shtrënguese dhe fillimin e procedurave administrative dhe ligjore për vjeljen e këtyre detyrimeve. Pjesa e kontabilizimit pranohet pjesërisht, sepse është kontabilizuar principlali i detyrimeve të paarkëtuara, por nga audituesi duhet të ishte kërkuar llogaritja dhe kontabilizimi i kamatëvonesave, të cilat i shtohen detyrimeve të paarkëtuara.

Sa më sipër, kjo pjesë e kundërshtive pranohet pjesërisht dhe ndryshimi është pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2. Lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë sqarojmë si vijon: ...Krahas njoftimeve të bëra subjekteve posedues të objekteve në proces legalizimi, paralelisht kemi njoftuar dhe ASHK-në Shkodër dhe Zyrën Vendore Pukë, dhe u kemi kërkuar mos lëshimin certifikatave të pronësisë në mënyrë kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga subjektet përfituese....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Nga grupi i auditimit është konstatuar që janë kryer procedura për njoftimin e debitorëve, por këto procedura nuk kanë qenë të plota, sipas të gjitha përcaktimeve në legjislacionin tatimor dhe administrativ dhe në asnjë rast nuk janë zbatuar masat shtrënguese.

Sa më sipër, kjo pjesë e kundërshtive nuk pranohet.

3. Lidhur me situatën e nivelit të lartë të debitorve dhe menaxhimin e borxhit tatimor nga taksat e tarifave vendore sqarojmë si më poshtë vijon: ...Lidhur me zbatimin e masave shtrënguese të parashikuara në ligjin nr.9920 / 2008 (të ndryshuar) , shpesh herë jemi ndeshur me reagime dhe kontestime nga ana e subjekteve debitor për taksat dhe tarifave vendore ndaj bashkisë Pukë, me pretendimin se, mbledhja e detyrimeve tatimore vendore për mes zbatimit të masave shtrënguese nën 90, 91 e në vijim të ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar bien ndesh me përcaktimet e nenit 100 " parashkrimi i së drejtës për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese " dhe 102/b " ndërprerja e procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor " të po këtij ligji. Pra subjektet kundërshtojnë veprimet tona (hapat shtrëngues që ndërmer administrate tatimore) me pretendimin se, e drejta për fillimin e procedurave për zbatimin e masave shtrënguese, sipas këtij kreu, parashkruhet brenda 5 viteve nga data kur detyrimi tatimor i papaguar duhej të kryhej. Ndodhur në këto kushte kërkojmë një rekomandim për këtë situatë pasi pjesa e madhe e debitorëve është e shtrirë për vite me radhë....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Në lidhje me njoftimet dhe procedurat për vjeljen e detyrimeve të papaguara, Bashkia Pukë nuk ka zbatuar të gjitha masat shtrënguese sipas përcaktimeve ligjore, madje nuk i ka trajtuar njësoj të gjitha subjektet, duke vepruar me dy standarde.

Për kalimin e afateve, etj, nga Bashkia Pukë nuk janë marrë në konsideratë përcaktimet në ligjin nr. 33/2017 *ËPër pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore*, si dhe nuk kanë filluar procedura gjyqësore për të gjitha subjektet debitorë.

Sa më sipër, kjo pjesë e kundërshtive nuk pranohet.

4. Lidhur me detyrimet e familjarëve sqarojmë si vijon:Për vitet 2019 - 2020 taksa e familjeve pa arkëtuar është në vlerën 211.860 dhe jo në vlerën prej 1.001.460 lek

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Kjo pjesë e kundërshtive pranohet dhe ndryshimi është pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

5. Lidhur me taksën e tokës bujqësore sqarojmë se: ...Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr. 6, aktit të pronësisë dhe certifikatës së regjistrimit të tokës. Në mungesë të këtij dokumentacioni zyra e tatimeve vendore ka planifikuar me rezervë taksën mbi token bujqësore. Planifikimi i kësaj takse është bërë referuar deklaratimeve të bëra nga vetë familjet fermere të cilët kanë përfituar tokë në bazë të ligjit për ndarjen e tokës....

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Në këtë pikë, nga grupi i auditimit nuk konstatohen kundërshti, por vetëm sqarime, të cilat personat e atakuar duhet t'ia bëjnë gjatë analizave dhe diskutimeve të brendshme për zgjidhjen e problemeve të mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave.

6. Pajisja me NUIS sekondare e Operatorëve Ekonomik të cilët kryejnë veprimtari biznesi në bashkinë Pukë : (fq 31 dhe 32 e Projekt Raportit të Auditimit)..., etj.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Njësoj si pika 6 më sipër.

7. Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre: (fq 32 dhe 33 e Projekt Raportit të Auditimit)....Për subjektet "S" shpk , me nr. nipti – K04004205V dhe "NO" shpk, me nr. nipti -L498233010 , referuar projekt raportit të auditimit është llogaritur për secilin subjekt vlera prej 1.100.000 lek, detyrime për autorizime, por asnjëri nga këto 2 subjekte nuk tregton gaz të lëngshëm (derivate).etj.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Kjo pjesë e kundërshtive nuk pranohet pasi nuk ka asnjë dokument që ta vërtetojë një gjë të tillë.

Pjesa tjetër e observacionit, e cila nuk është përmendur në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit përmban vetëm komente dhe/ose justifikime, të pashoqëruara nga fakte dhe dokumente të reja, të panjohura nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit në terren. Për sa më sipër, kundërshtitë merren në konsideratë pjesërisht.

2.2. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”

2.2.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.2.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionitfinanciar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.2.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare

❖ **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2020 njësia shpenzuese **oBashkia Pukë** për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 *oPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Pukë dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

❖ **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2020 nga verifikimi për çdo muaj i ditari kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të

shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitja e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

❖ Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit të Bashkisë:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë elektronike në programin *Excel*

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Përditësimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmbajnë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu, dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrjedaljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

❖ Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2020 deri në datën 31.12.2020.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2020.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat janë regjistruar në momentin e çeljes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës:

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar dhe të analizuar përsa i përket aseteve e ish-Komunave. Ndërsa detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilanc.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese:

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, ndërsa mungojnë shënimet që të shprehin paqartësitë e ndodhura.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2020 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2019.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2019-2020 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2020 është **1,473,617,025** lekë dhe për vitin 2019 është **1,545,808,889** lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari, sipas **Aneksit nr. 2/1**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2020, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivit dhe të pasivit, si në vijim.

Për vitin 2020.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit: llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave.

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; **llogaria 520** *“Disponibilitete në Thesar”*, në pasqyrat financiare është për vlerën për vlerën debitorë **82,386,492** lekë.

Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Pukë, kjo llogari **është për vlerën 82,386,492 lekë.**

Kjo vlerë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, është e analizuar si vijon:

Nr.	Llogaria	2020
1	Llogaria 520 <i>“Disponibilitete në thesarö</i>	82,386,492
2	Llogaria 466 <i>“Kreditorë për mjete në ruajtjeö</i>	11,346,683
3	Llogaria 85 <i>“Rezultati i veprimtarisë së ushtrimitö</i>	13,556,207
4	Llogaria 12 <i>“Rezultatet e mbarturaö</i>	57,622,885

- Llogaria 520 *“Disponibilitete në Thesar”* është e rakorduar **me të dhënat** e Degës së Thesarit, në pasqyrat financiare, duke pasqyruar saktë vlerën e saj në fund të vitit ushtrimor në vlerën **82,386,492 lekë**, në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö*, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50.

2. Nënrubrika, gjendje e inventarit qarkullues, gjendja e llogarisë **31 “Materiale”**, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 3,578,729 lekë. Vlerat e kësaj

Ilogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

-Gjendja e llogarisë **32 “Inventar i imët”** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 15,303,266 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

3. Nën rubrika, llogari të arkëtueshme,- gjendja e llogarisë **468 “Debitorë të ndryshëm** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2019 paraqitet në vlerën 50,479,113 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 44,521,576 lekë, të cilat janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontrolleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2020 e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike sipas aneksit nr 2.2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Gjendja e llogarisë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta”** (debitorë) më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 17,124,416 lekë, më 3.12.2020 paraqitet në vlerën 20,754,572 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie për vitin 2020 për vlerën 20,754,572 lekë konstatohet se:

1-detyrimet për paga ndaj personelit, të pasqyruara në llogarinë 42 *Personeli e llogari të lidhura me toö*, në vlerën 10,198,504 lekë,

2-sigurime shoqërore në vlerën 2,932,147 lekë të pasqyruara në llogarinë 435 *öSigurime shoqëroreö*,

3-sigurime shëndetësore në vlerën 401,111 lekë, të pasqyruara në llogarinë 436 *öSigurime shëndetësoreö*

4-detyrimet ndaj shtetit për tatime e taksa të pasqyruara në llogarinë 431 *öDetyrime ndaj shtetit për tatime e taksaö*, në vlerën 518,406 lekë,

5-detyrime ndaj furnitorëve, të pasqyruara në llogarinë 401-408 *öFurnitorë e llogari të lidhura me toö*, në vlerën 6,704,404lekë.

Nuk rezulton diferencë midis vlerës së pasqyruar në llogarinë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruara në 5 (pesë) llogaritë pasive**, pra në vitin 2020, është e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

4. Nën rubrika, të tjera aktive afatshkurtra, gjendja e llogarisë **486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”**, më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 57,864,242 lekë, kurse më 3.12.2020 paraqitet në vlerën 59,250,683 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrimet e prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlera debitore e kësaj llogarie, është e **kuadruar me shumën e llogarisë kreditore të pasivit të bilancit, respektivisht në llogarinë 467 öKreditorë të ndryshëmö** në shumën totale **59,250,683 lekë** në përputhje të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 *öPër procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeö*, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi 01, *öAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik.ö* Në mënyrë analitike paraqitet në aneksin nr 3. pika 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

II. Rubrika, aktivet afatgjata.

1. Nën rubrika, aktive afatgjata jo materiale, gjendja e llogarisë **202 “Studime dhe kërkime”**, më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 821,916 lekë, ndërsa më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 698,629 lekë, me diferencë në ulje në vlerën 123,287 lekë e cila përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur për vitin 2020. Kjo llogari është e analizuar si vijon:

Llogaria 202 *öStudime e kërkimeö* dhe vlerat përkatëse, gjendje më 31.12.2020.

Nr.	EMERTIMI I llog Nr. 202	Kosto historike	Amortizimit	Teprica neto
1	Studim projektim kanali Bushat	288,711	43,307	245,404
2	Studim projektim Ujesjellesi Bicaj	99,705	14,956	84,749
3	Studim projektim Ura Kavlibne	216,750	32,513	184,238
4	Studim projektim rruga Lumzi	216,750	32,513	184,238

	Inventari kontabël 31.12.2020	821,916	123,287	698,629
--	--------------------------------------	----------------	----------------	----------------

Sipas inventarizimit fizik përsa janë kontabilizuar në debi të kësaj llogarie.

2. Nën rubrika, aktive afatgjata materiale.

-Gjendja e llogarisë 210 **“Toka, Troje, Terrene”** në datën 31.12.2019, paraqitet në vlerën 1,202,645 lekë, në 31.12.2020 paraqitet po në vlerën 1,202,645 lekë e pa ndryshuar. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera ndër vite. Kjo llogari është e analizuar në mënyrë kontabël sipas të dhënave si më poshtë vijon:

Nr	Emërtimi	Kosto historike
1	Gropa mbeturinave F-qarri Bashkefinancim me donatore	475,231
2	Përmirësim i gropës mbeturinave stadiumifondac ABC	299,014
3	Leje Mjedisore	32,400
Njësia Gjegjan		
4	Ndërtim sheshi per mbledhje	396,000
	SHUMA 31.12.2020	1,202,645

Sipas inventarizimit fizik përsa janë kontabilizuar në debi të kësaj llogarie.

-Gjendja e llogarisë 211 òPyje kullota plantacione në datën 31.12.2019, paraqitet në vlerën 10,348,227 lekë, në 31.12.2020 paraqitet po në vlerën 8,278,582 lekë e pa ndryshuar. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera ndër vite. Kjo llogari është e analizuar në mënyrë kontabël sipas të dhënave si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi	Teprica neto 2019	Amortizimi 2020	Teprica neto 2020
1	Pyllezime me akaciefshati qelez komuna qelez	846,744	169,349	677,395
2	Pyllezime me geshtenjedhe lajthi shpati I kishesqelez	713,852	142,770	571,082
3	Pyllezime me dru dekorativ ne varrezat e fshatrave kalivare dhe gjegjan k. gjegjan	1,274,669	254,934	1,019,735
4	Pyllezime me arre dhe akacie ek pyjore buhot,bicaj komuna rrape	1,887,153	377,431	1,509,723
5	Gjelberimi Luf Komuna Luf -Qerret	230,400	46,080	184,320
6	Blerje dru frutore Komuna Qerret	1,183,565	236,713	946,852
7	Pyllezime GomsiqeKomuna Qerret	1,546,647	309,329	1,237,318
8	Pyllezimme Luf Komuna Qerret	942,035	188,407	753,628
9	Pyllezimme Luf-Kcire Komuna Qerret	1,423,162	284,632	1,138,530
10	Blerje fidane	300,000	60,000	240,000
	TOTALI BASHKIA+NJESITE	10,348,227	2,069,645	8,278,582

Sipas inventarizimit fizik përsa janë kontabilizuar në debi të kësaj llogarie.

- Gjendja në llogarinë 212 **“Ndërtime e konstruksione”** më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 488,209,513 lekë. Më 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie rezulton 465,708,027 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, paksimet janë vetëm për vlerën e amortizimit në përputhje të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Në mënyrë analitike paraqitet në aneksin nr 4. pika 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Gjendja në llogarinë 213 **“Rrugë, rrjete vepra ujore”** më 31.12.2019, paraqitet në vlerën 625,590,852 lekë, më 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie rezulton 547,712,520 lekë, e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës, paksimet janë vetëm për vlerën e amortizimit, në përputhje të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Në mënyrë analitike paraqitet në aneksin nr 5. pika 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- Gjendja e llogarisë 214 **“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 14,919,994lekë, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 15,385,704 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite, shtesat gjatë periudhës dhe

paksimet nga amortizimi. Gjendja e kësaj llogari në mënyrë të përmbledhur është analizuar sipas inventarit fizik.

- Gjendja e llogarisë **215 “Mjete transporti”** më 31.12.2019 në vlerën 4,410,932 lekë, më 31.12.2020 në vlerën 8,508,746 lekë. Gjendja e kësaj llogari në mënyrë të përmbledhur është analizuar si vijon:

Analiza e llogarisë 215 “Mjete transporti” për vitin 2020.

Nr. Rendor	EMERTIMI	Sipas te dhenaveKontabile	
		Sasia	Vlera
1	Kamion teknologjik tip ÷Voloö targe Tr 8826R,	1	3,480,000
2	Makine Teknologjike per mbetjet tip Renaultngjyre e bardhe Nr. Shasise VF644ACA000004277	1	2,820,000
3	Makine ÷Foristradeö	1	2,070,000
4	Mercedes Benz -MLøngjyre gri Nr.Shasise PC 161131MA 275250	1	650,000
5	Rover AA339AR ngjyre e bardhe . Nr.Shasise SALLJGMF8VA543058	1	270,000
6	Kompatator	1	2,940,000
7	Kamionçine me targe SH808IE, Nr shasise AIMLER, DB9044121P90036	1	960,000
8	Kamion me targe AA681MO,Nr shasise MAT040600M2585527	1	4,020,000
1	MjetZjarrfikese MAN	1	20,400
2	Mjet Zjarrfikese Steyer	1	700,000
3	Mjet Zjarrfikese Ford Tranzit	1	480,000
4	Mjet tip Steyr-- PUCH Pinzgrauer 712, Nr Shasie 47538337 , Targa PU 15185 A	1	350,000
5	SAURER Automjet nr.shasie 201778317Viti 1964	1	5,470,000
1	Land Rover ngjyre blu e erret NR. ShasiseSALLJGMF8VA543058	1	380,000
1	Makine	1	350,000
	Shuma		24,960,400

Sipas inventarizimit fizik përsa janë kontabilizuar në debi të kësaj llogarie.

-Gjendja e llogarisë **218 “Inventar ekonomik”**, më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 28,786,824 lekë, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 23,971,542 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite dhe pakësime gjatë vitit 2020, sipas listës analitike të sektorit të financës.

Për vitin 2020 gjendja e llogarisë **219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”**, amortizimi i AQT-ve nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto paraqiten në formatin 7/a dhe 7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 ÷Për tatimin mbi të ardhuratö, i ndryshuar; si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019ö Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshmeö.

3. Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 ÷Huadhënie e nën huadhënieö dhe 6 ÷Pjesëmarrje në kapitalin e vetö, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 3,500,000 lekësipas vlerës nominale të aksioneve të KF TËRBUNI.

Titulli i gjetjes: Mos kotabilizimi i vlerës monetare 137,423,000 lekë, në llogarinë 26 ÷Aktive afatgjata financiareö si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjiellës Kanalizime Pukë SHA me NUIS ÷K43522604Gö

Situata: Për vitet 2020 rezultoi se: Bashkia Pukë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2020 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjiellës Kanalizime Pukë SHA me NUIS ÷K79121308Sö e cila është shoqëri aksionare me objekt ÷Shërbimi i furnizimit me

ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 137,779 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 137,779,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pukë në ÕUjësjellës Kanalizime Pukë ShA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020, më konkretisht në llogarinë 26 ÕPjesëmarrje në kapitalet e veta Õ në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ÕPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar Õ me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ÕAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materiale Õ pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 ÕTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje Õ. Përsa me sipër, ngarkohet me përgjegjësi: znj. F. P., në cilësinë e Drejtorit të Financës për periudhën 2020

Kriteri: Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 ÕPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare Õ, Urdhrin e MF nr. 64, datë 22.7.2014 ÕPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar Õ, me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 ÕAktivet afatgjata Materiale dhe Aktivet afatgjata Jo materiale Õ, pika 55, 56 dhe 57.

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar mbi gjendjen kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiar viti 2020, të llog 26 ÕPjesëmarrje në kapitalet e veta Õ, çka ka sjellë një nënvlerësim të llog 26 në vlerën 137,423,000 lekë.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjor në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Pukë, nëpërmjet Nënpunësit zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek ÕUjësjellës Kanalizime Pukë” Sh.A. me vlerë 137,423,000 lekë, në debi të llog. 26 ÕPjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Titulli i gjetjes: Paraqitja e llogarisë 231 “Për aktive afatgjata materiale” pa dokumenta analitike, për sa janë regjistruar në kredi të llogarisë 231.

Situata: Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 153,198,003 lekë, në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 168,337,577 lekë, e cila përfaqëson, vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 ÕAktive afat gjata materiale Õ. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Sektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2020 në vlerën 113,161,717 lekë, sipas aneksit nr. 9 pika 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ÕPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme Õ, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, ÕAktive afatgjata materiale Õ dhe pika 33.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën janë vlersuar pargullësitë janë; UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ÕPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme Õ, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2,

nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, òAktive afatgjata materialeò dhe pika 33.

Ndikimi/Efekt: Deformim i informacionit financiar mbi gjendjen kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiare viti 2020, të llog 231 “Për aktive afatgjata materiale”.

Shkaku:Mos zbatim i kuadrit ligjorë në fuqi.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi:Drejtoria Ekonomike të marrë masa për sistemimin e llogarisë 231 òPër aktive afatgjata materialeò, në mënyrë që kjo llogari të pasqyrojë vlerën reale të Aktive afatgjata materialeduke plotësuar dhe mangësitë e dokumentacionit në listat analitike.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nëpërmjet postës elektronike në adresën himeraj@klsh.org.al në datën 23.12.2021, ku janë paraqitur kundërshtitë, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Vlera prej 168,337,577 lekë përbëhet nga shuma e investimeve në vite por që akoma nuk janë marrë në dorëzim përfundimtar, pra nga ana e zyrës përkatëse nuk është hartuar çertifikata e marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit me qëllim kapitalizmin e kësaj vlere në llogaritë e klasës 2. (pra është certifikata e përkohshme por jo ajo e përhershme e marrjes në dorëzim).

Oëndrimi i grupit të auditimit: Pretendimet e subjektit Bashkia Pukë nuk do të merren në konsideratë pasi: nga audituesi i çështjes nuk është ngritur pretendim se e gjithë vlera 168,337,577 lekë nuk ka òDokumentacion analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëseò, por i është referuar vlerës 113,161,717 lekë sipas aneksit nr. 9 pika 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të cilat janë investime të viteve paraardhës respektivisht të viteve 2017-2019 të cilat duhet të ishin marrë në dorëzim nga Bashkia Pukë, në respektim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, òAktive afatgjata materialeò dhe pika 33.

II. Rubrika, pasivet afat shkurtra.

1. Nënrubrika, llogari të pagueshme, gjendja e llogarive të 401-408 òFurnitorë dhe llogari të lidhura me toò, të 42 òPersoneli e llogari të lidhura me toò, -të 431 òDetyrime ndaj shtetit për tatim-taksaò, të 435 òDetyrime ndaj shtetit për sigurime shoqëroreò, të 436 òDetyrime ndaj shtetit për sigurime shoqëroreò, janë të barabarta me gjendjen e llogarisë 4342 òOperacione me shtetinò në vlerën 20,754,572 lekë për vitin 2020. E analizuar për vitin 2020 për vlerën 20,754,572 lekë përbëhet dhe është e njëjtë me shumën e llogarive si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2020
1	Paga Personeli llogaria 42	10,198,504
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	518,406
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	2,932,147
4	Sigurime Shëndetësore llogaria 436	401,111
5	Furnitorëllogaria.401-408	6,704,404
	TOTALI	20,754,572

Nuk rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruara në 5 (pesë) llogarive pasive, pra në vitin 2020 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

-Gjendja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 6,704,404 lekë, për 20 subjekte e cila përfaqëson detyrimet e Bashkisë ndaj të tretëve brenda afatit 60 ditor të likuidimit të detyrimeve në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20 si vijon;

Nr.	Emërtimi i furnitorit	Shuma totale	Ndarë sipas vitit të lindjes së detyrimit nga viti 2020	
			nga muaji dhjetor	
	Llog.401-404		datë fature	vlera
1	Ujesjelles kanalizime SHA	211,154	28.12.2020	211,154
2	Dega e Postes Puke	22,290	31.12.2020	22,290
3	O. sha	5,800	31.12.2020	5,800
4	A. sha	2,000	31.12.2020	2,000
5	A. sha	2,000	31.12.2020	2,000
6	A. sha	9,996	31.12.2020	9,996
7	B.	74,527	24.12.2020	74,527
8	OSHE	1,026,752	31.12.2020	1,026,752
9	N. shpk	910,786	14.12.2020	910,786
10	A. O.	767,880	20.12.2020	767,880
11	D.	9,600	30.12.2020	9,600
12	G. shpk	222,360	22.12.2020	222,360
13	L. shpk	35,441	23.12.2020	35,441
14	O. Q.	194,000	10.12.2020	194,000
15	M. A.	12,802	31.12.2020	12,802
16	N. shpk	145,176	30.12.2020	145,176
17	M. K.	5,640	18.12.2020	5,640
18	D. shpk	3,046,200	21.12.2020	3,046,200
	TOTALI	6,704,404		6,704,404

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Pukë.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë 466 òKreditorë për mjete në ruajtje.

Situata: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, më 31.12.2019, paraqitet në vlerën 10,733,279 lekë, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 11,346,594 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga analiza e kësaj llogarie, **konstatohet se:**

Për vitin 2020 nga Bashkia, Drejtoria e financës ka të dokumentuar ngurtësimet gjatë vitit 2020 në vlerën 11,346,594 lekë për 36 subjekte. Gjatë vitit 2020 shesta janë në vlerën **2,723,431 lekë** dhe likuidimet e kryera në vlerën **2,110,116 lekë për 3 subjekte**. Sipas akt rakordimeve midis Bashkisë Pukë dhe degës së thesarit Pukë.

Si përfundim konstatohet se: Për 29 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 9,188,341 lekë, sipas aneksit nr.6, pika 2, nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet e mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50.

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 òPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimito i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50.

Ndikimi/Efekti: Deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 466 òKreditorë për mjete në ruajtje.

Shkaku: Mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia:E Mesme

Rekomandimi:Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë pranë Degës së Thesarit Pukë për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni nëpërmjet postës elektronike në adresën himeraj@klsh.org.al në datën 23.12.2021, ku janë paraqitur kundërshtitë, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në çdo rast kur është sjelle në zyrën e financës dokumentacioni për çlirimin e garancisë ajo është çliruar konform procedurave ligjore në momentin e plotësimit të afatit subjekti bën kërkesë bashkisë për dorëzim përfundimtar të objektit, ngrihet grupi i punës me përfaqësues të Bashkisë, Subjektit, supervizorit, kolaudatorit etj, hartohet dokumentacioni përkatës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pretendimet e subjektit Bashkia Pukë nuk do të merren në konsideratë pasi nuk është zbatuar UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimito i ndryshuar, Kap. II, pika 10, ku citohet fakti: “Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtimontimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve”, duke mbajtur procesverbalet përkatëse për secilin objekt.

Titulli i gjetjes: Mungesa e sektorit të menaxhimit të aseteve si dhe e regjistrimit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Pukë.

Situata: Për vitin 2020 struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 79 datë 27.12.2019. Rezulton se në strukturën aktuale organizative të bashkisë Pukë nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, sipas UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko* me qëllim rritjen e mundësisë e të ardhurave nga dhënia me qira si rjedhoj nuk është krijuar regjistri i aseteve për të gjitha pronat e transferuara nga ish komunat, në kundërshtim me kapitullin III *oRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyreo*, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *oPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko*; nenin 8, të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 *oPër pronat e paluajtshme të shtetit*, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 *oPër inventarizimin pronave në njësitë e qeverisjes vendore e pronave të paluajtshme shtetërore*, Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 *oPër inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore*, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 *oPër mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publikeo*.

Rezulton se Bashkia Pukë me vendimet përkatëse të KB, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë Pukë dhe Njësitë Administrative Pukë, si vijon:

Bashkinë Pukë është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike,

shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Pukë, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM nr. 140, datë 23.02.2011 *“Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Pukë, të Qarkut të Pukës”* Lista përbëhet nga 92 (nëntëdhjetë e dy) fletë dhe përfundon me numrin rendor 491 (katërqind e nëntëdhjetë e një).

Njësinë Administrative Qerret është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Komunës Qerret, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM nr. 26, datë 14.01.2009 *“Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Qerret, të Qarkut të Pukës”*.

Njësinë Administrative Qelëz është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Komunës Qelëz, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM nr. 648, datë 31.07.2013 *“Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Qelëz, të Qarkut të Pukës”*.

Njësinë Administrative Rrapë është miratuar lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bazë të VKM nr.306, datë 10.04.2004 *“Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Rrapë”*.

Njësinë Administrative Gjegjan është miratuar lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bazë të VKM nr .18, datë 09.01.2008 *“Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Gjegjan”*. Lista e inventarit përbëhet nga 127 (njëqind e njëzet e shtatë prona).

Përsa i përket pronave të Kaluara me VKM në Njësitë Administrative (Qarrëz, Qelëz, Rrapë Gjegjan) për vitin 2020 nuk janë kryer veprime për regjistrimin e pronave dhe pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Pukë; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Pukë, për asetet pronë e ish Komunës, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese objekteve pronë e ish Komunës; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje; nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të aseteve, si dhe nuk është aplikuar në ZVRPP për regjistrimin e tyre. Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, dhe UMF-së nr. 30, datë 27.12.2011 **“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III**, pika 30 ku citohet: *“Formati i regjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”* dhe pika 35/a ku citohet: *“Dokumentet vërtetues- vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet mandate arkëtimet, mandate pagesat, procesverbalet dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.”*

Në mënyrë të përmbledhur pronat e kaluara me VKM dhe të regjistruara në ASHK paraqiten si më poshtë:

Nr.	Bashkia/ Njësitë	Nr. Pronave	Nr. i Praktikave të	Nr. Praktikave të	Prona të pa
-----	------------------	-------------	---------------------	-------------------	-------------

		në Inventar	Certifikuara Deri Dhjetor 2017	Certifikuara 2019-2020	Regjistruara
1	Puke	114	15	20	79
2	Qarret	120	9		111
3	Qelez	67	3		64
4	Rrape	105	1		104
5	Gjegjan	127	1		126
6	Pyje	2763	183	30	2550
7	Totali	3296	212	50	3034

Kriteri: Ligji nr.8744, datë 22.2.2001 *“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”,* ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,* pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,* të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 *“Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”,* i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 *“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”. Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”,* të ndryshuar,

Ndikimi/Efekti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar

Shkaku: Mungesa e sektorit të menaxhimit të aseteve si dhe e regjistrimit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Pukë

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Pukë dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore.

Kryerja e Inventarizimit dhe Vlerësimin të Aktiveve

Për vitin 2019, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”* nga ana e titullarit të bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhëri nr.335 datë 03.12.2019 *“Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të elementëve të pasurisë”* në Bashkisë Pukë, përfshirë këtu dhe njësitë administrative për vitin 2019. Pasi është mbajtur proces-verbali i vlerësimit, janë identifikuar materiale për nxjerrje jashtë përdorimit për llogarinë 215 *“Mjete Transporti”* të cilat janë nxjerrë jashtë përdorimit në vitin 2020, të cilat ishin totalisht jo funksionale nga bashkia dhe ish komunat. *Procedurat e ndjekura nga ana e Bashkisë për “Mjetet e nxjerra jashtë përdorimit” janë si vijon;*

-Me urdhërin nr. 48 datë 26.02.2020 dhe me urdhërin nr. 49 datë 26.02.2020 të kryetarit të bashkisë z. Gj. Gj. janë përcaktuar mjetet të cilat do të vlerësohen nga grupi i punës dhe nga eksperti i licencuar z. Gj. K. me nr. license M. 0171/2.

Janë mbajtur proces verbali për secilin mjet dhe raportet përmbledhëse të konfirmuar nga nëpunësi autorizues, në vijim të procedurës ka dalë urdhëri nr. 301 datë 18.11.2020 *“Për nxjerrjen jashtë përdorimit të mjeteve dhe shitjen e tyre për skrapo”*

Me urdhërin nr. 2 datë 11.01.2021 është krijuar grupi i punës për *“Zhvillimin e Ankandit”* dhe me shkresën nr. 27/3 datë 11.01.2021 i është dërguar informacion Agjencisë së Prokurimit Publik mbi njoftimin e shpalljes së Ankandit, i hapur me objekt *“Shitje e mjeteve të transportit me procedurë ankandi publik”.*

Me shkresën nr. 27/7 prot datë 22.02.2021 është bërë miratimi i procedurës së ankandit të hapur, me shkresën nr. 27/9 datë 23.02.2021 është bërë njoftimi i fituesit të ankandit publik

dhe me shkresën nr. 27/10 datë 12.03.2021 është lidhur kontrata ndërmjet Bashkisë Pukë dhe sipërmarrësit z. P. Ll.

Për vitin ushtrimor 2020 Titullari ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 352, datë 30.12.2020 *“Për ngritjen e grupeve të punës për kryerjen e inventarizimit fizik, vlerësimin dhe evidentimin e aktiveve të cilat janë të amortizuara dhe duhet të nxiren jashtë përdorimit, Bashkia Pukë, institucione të varësisë dhe Njësitë Administrative” për vitin 2020.*

Në përfundim të procesit të inventarizimit komisioni inventarizimit ka paraqitur fletë inventarët me gjendje fizike e krahasuar kjo me gjendjen kontabël (*vlera historike*) në objektet e inventarizuara sipas llogarive kontabël të evidentuara në përmbledhëse me rezultate të evidentuara dhe të rakorduara me pasqyrat financiare (*bilanci kontabël*) për periudhën raportuese e mbyllur në datë 31.12.2020 si dhe ka propozuar materialet të cilat janë të dëmtuara dhe që duhen nxjer jashtë përdorimit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion materialet e nxiera jashtë përdorimit, janë materiale të cilat janë konstatuara të dëmtuara nga komisioni i inventarizimit i vitit 2019 dhe procedura e tyre është zhvilluar gjatë vitit 2020 të cilat janë hequr nga kontabiliteti në pasqyrat financiare të vitit 2020. Edhe pse gjatë vitit 2020 komisioni ka konstatuar materiale të dëmtuara dhe që duhet të nxiren jashtë përdorimit nga ana e nëpunësit autorizues nuk janë kryer veprime të tjera për vazhdimin e procedurave të mëtejshme. Në mënyrë të përmbledhur gjendja e 13 llogarive sipas inventarit fizik dhe kontabël si dhe analizës për secilin aktiv afatgjatë material, jo material dhe qarkullues është si më poshtë:

Nr	Llogaria	Gjendja në lekë		Diferenca		
		Kontabel	Fizik	Teper	Mangut	Jashte Përdorimi
1	214	22,389,342	22,389,342	0	0	0
2	218.1	17,926,314	17,077,743	0	0	848,371
3	218.6	20,635,046	19,081,778	0	0	1,553,268
4	218.7	36,057,113	34,010,897	0	0	2,046,216
5	215	24,960,400	24,960,400	0	0	0
6	312	3,578,729	3,578,729	0	0	0
7	202	1,137,600	1,137,600	0	0	0
8	210	1,202,645	1,202,645	0	0	0
9	211	16,000,355	16,000,355	0	0	0
10	212	636,856,859	636,856,859	0	0	0
11	213	943,818,972	943,818,972	0	0	0
12	231	168,337,577	168,337,577	0	0	0
13	350	181,233	181,233	0	0	0
14	327	15,303,265	12,805,083	0	0	2,498,182
15	532	1,572,040	1,572,040	0	0	0
	TOTALI	1,909,957,490	1,903,011,253	0	0	6,946,037

Titulli i gjetjes: Mos kontabilizimi i kontratave të lidhura për vitet 2019-2020, për 7 kontrata në vlerën 33,657,277 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Ministrinë linjës dhe FZHR.

Situata: Për vitet 2019-2020 janë lidhur dhe zbatuar 11 kontrata në vlerën 108,626,177 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Ministrinë e linjës dhe FZHR. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogaritë e

aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, që kanë lidhje me 7 kontrata, ku vlera e mbetur e palikujduara e tyre prej 33,657,277 lekë nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 “*Të ardhura të caktuara për t’u përdorur*”.

Për këto investime nuk janë kryer veprimet kontabël sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike, kështu:

Me çeljen e fondeve mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve duhej kryer veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llog. 520 *Disponibilitete në thesarë* në kredi të llog. 476 “*Të ardhura të caktuara për t’u përdorur*”.

Me konstatimin e shpenzimit (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) duhej bërë veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 *Investime për aktive afatgjata materiale*, në kredi të llogarisë 404 *Furnitor për investime*.

Në momentin e pagesave të faturave duhej kryer kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 *Furnitorë* për investime dhe në kredi të llogarisë 520 *Disponibilitete në thesarë*.

Në fund të vitit ushtrimor për fondet e përdorura për **investimet në proces** të pa përfunduar duhej kryer veprimi kontabël në debi të llog. 476 *Të ardhura të caktuara për t’u përdorur* në kredi të llog. 720 “*Grant korrent i brendshëm* dhe në kredi të llog. 4342, *Operacione me shtetin (të drejta)*” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

Me përfundimin e investimit të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës është bërë kapitalizmi aktivitet (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhej prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 *Aktive afatgjata materiale* në kredi të llogarisë 231 *Investime për aktive afatgjata materiale*.

Me kapitalizmin e aktivitetit (për aktivitet e marra në dorëzim) duheshin kryer veprimet kontabël:

- në debi të llogarisë 476 *Të ardhura të caktuara për t’u përdorur* në kredi llog. 105 *Grante të brendshme kapitale* për fondet buxhetore të përdorura për investime dhe

- në kredi të llogarisë 1011 *Shtesa të fondit baze* në debi të llogarisë 105 “*Grante të brendshme kapitale*” për vlerën e aktiveve të blera.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 *Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme* Aneksi 1 *Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik* kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a, b, Kreu III pika 32.

U kryen procedura testimi analitik me përzgjedhje kampionesh për zona të ndryshme llogarish, duke bërë verifikim të fondeve të planifikuar dhe të përdorura, të përlllogaritjeve të vlerave për transaksione financiare të kryera si rezultat i ndodhjes së ngjarjeve ekonomike si dhe verifikimi i përputhshmërisë ligjore i dokumentacionit shoqëruar mbështetës nëse ato ishin kryer në përputhje me kërkesat e ligjit nr.139/2015 *Për Vetëqeverisjen Vendore* neni 40 *Shpenzimet* pika 1.

Kriteri: VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*, Kapitulli I, pika 1. me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 *Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme* kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a, b, Kreu III pika 32.

Impakti: Moskontabilizimi i kontratave të investimeve për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale në të gjitha fazat e kryerjes së veprimeve ekonomike për to, ka sjellë mosparaqitje të plotë të detyrimeve të lindura nga angazhimet financiare të krijuara nga lidhja e kontratave me të tretët si dhe fondeve të përdorura për to, gjë që ka sjellë ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me detyrimet e lindura të

konstatuara, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Pukë, të kryejë të gjitha veprimet e kontabilizimit sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike për kontratat e lidhura për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, duke pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar që nga çelja e fondeve, me konstatimin e shpenzimit (mbërritja e faturës), deri në kapitalizimin e aktivitetit dhe jo thjesht, kur ndërhyjnë pagesa, pasi evidentimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin gradual të tij.

Përsa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi: znj. F. P., në cilësinë e Drejtorit të Financës për periudhën 2020.

-Testimi i llogarisë 600 "Pagat dhe shpërblime"

Për vitin 2020 numri i punonjësve është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 79 datë 27.12.2019. Miratuar në total numri i punonjësit + QKB dhe Gjendjes Civile = 291 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 283 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Pukë është miratuar me Urdhër nr. 162 datë 07.07.2020 të Kryetarit të Bashkisë.

Sipas listë pagesave të muajve janar 2020, shtator 2020 dhe dhjetor 2020 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës znj F. P. dhe nga Kryetari i Bashkisë Pukë.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës znj F. P. dhe nga zv/Kryetari Bashkisë; z. M. K..

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjse e sektorit të Burimeve Njerëzore znj Dh. M. dhe nga zv/Kryetari Bashkisë z. M. K..

Auditimi me zgjedhje i disa dosjeve të personelit (krvesisht ato me arsim të lartë).

Në auditimin e dosjeve të personelit krahasuar me nivelin e klasave, kategorinë, pagën e grupit, shtesat për vjetërsi, vështirësitë, pozicion, etj, u konstatua se janë në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 *“Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore si dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore*, i ndryshuar, dhe në dosjet personale të nëpunësve administrohet:

- Dokumenti i identifikimit (fotokopje letërnjoftimi); dokumenti mbi gjendjen civile (certifikata e gjendjes familjare); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor në fushën e studimeve (fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave); dokument i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti); raporti mjeko ligjor; librezë pune; fotografi; CV; letër Motivimi; Dëshmi të tjera kualifikimi. Disa nga dosjet që u audituan:

Nr.	Embër Mbiemër	Paga sipas kategorive	Përvoja punë
1.	F. P.	14000	23
2.	E. K.	14000	10
3.	B. A.	14000	12
4.	N. A.	14000	13
5.	Sh. S.	14000	25

Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2020

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar 2020 dhe Dhjetor 2021) konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkuara nga znj. Dh. M.. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, *õKodi i Punësõ*, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Pukë, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 *õPër tatimin mbi të ardhuratõ*, me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 *õPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSHõ*.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Pukë, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar 2020 dhe Dhjetor 2021) konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës znj. Dh. M. nga Specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga zv/Kryetari Bashkisë z. M. K..

***Transaksionet financiare nëpërmjet arkës.**

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:

Me arkë janë kryer transaksione financiare, si arkëtim të ardhurash për detyrime nga taksa e tokës bujqësore, taksat e tarifave familjare, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuar me të gjitha ekstremitetet, sipas faturës për arkëtim e lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, arkëtim gjopa të policisë Bashkiake. Nga arka nuk është kryer asnjë transaksion pagese. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkuar nga personi përgjegjës për arkën dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës.

Për vitin 2020, janë prerë Mandat Arkëtime në vlerë 3,039,547 lekë dhe mbyllet me MA, në vlerë 3,039,547 lekë.

Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës konstatohet se të ardhurat nga arkëtimet e kryera për vitin, 2020 janë derdhur totalisht në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të çdo viti është me zero lekë. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara janë bërë derdhje në Bankë në mënyrë periodike dhe arka rezulton me gjendje zero në fund të muajit. Gjithashtu është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *õPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlõ*, si dhe të UMF nr.30, datë 27.12.2011 *õPër Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikõ* pikat 63,64. Nga Drejtoria e Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit Pukë për të ardhurat.

Mallra dhe shërbime (llogaria 602)

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkuara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël. Në menyre të detajuar pagesa sipas llog. 602 paraqitet në Aneksin nr. 8 bashklidhur Projekt Raportit të auditimit.

2.3. Të ndryshme të dala gjatë auditimit

Mbi ankesën e shoqërisë "B.", Sh.A., përfaqësuar nga av. S. C.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Pukë, në lidhje me ankesën e shoqërisë së sipërpërmendur, u konstatua se:

- Ankesa e shoqërisë òB.ò Sh.A., e protokolluar në KLSH me nr. 268, datë 17.02.2021, është protokolluar në Bashkinë Pukë me nr. 433 prot, datë 17.02.2021.
- Sipas kontratës së qerasë nr. 26 prot. datë 03.02.2015, shoqëria òB.ò Sh.A., ka marrë me qera një sipërfaqe pyjore prej 83,451.88 m², me një afat 6-10 vjet, me qëllim realizimin e projekteve të ndryshme të ndërtimit në funksion të shfrytëzimit të minierës Karma 2, nga e cila është likujduar vlera 653,642 lekë, për vitin 2015.
- Kontratës së qerasë i është bashkëlidhur dokumentacioni përkatës, duke përcaktuar saktë pronat sipas listës së inventarit të pronave të ish komunës Qerret, bazuar në VKM-në nr. 599 datë 14.05.2008 *òPër Miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të Njësisë së Qeverisjes Vendore, Komuna Qerret, të Qarkut Shkodërò*, si dhe duke hedhur dhe evidentuar pronat në menyre të qartë në hartë aty ku është dhënë edhe leja e kësaj zone minerare.
- Shoqëria òB.ò Sh.A., në shkresën nr. 89 prot., datë 31.05.2016, drejtuar Bashkisë Pukë, ka kërkuar zgjidhjen e kontratës së qerasë me pretendimin se pasuritë nr. 323 dhe nr. 326, objekt i kontratës së qerasë nuk ndodhen në zonën e minierës Karma 2.
- Në kuadër të organizimit të bashkisë Pukë dhe Njësisë Administrative, bazuar në ligjin nr. 115/2014 *òPër ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendoreò*, si dhe VKM-së, nr. 510 datë 10.06.2015 *òPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorialò*, zyra e tatim-taksave pranë bashkisë Pukë, pas transferimit të dokumentacionit nga ish Komuna Qerretsot Nj.A. Qerret, bashkia Pukë, i ka dërguar shoqërisë òB.ò Sh.A., njoftimin për shlyerjen e detyrimit vendor tarifë qeraje për vitet 2016-2017 me shkresat nr. 2072 prot., dt. 09.11.2016 dhe nr. 198/2 prot., datë 03.02.2017.
- Nga ana e shoqërisë òB.ò Sh.A. nuk janë bërë pagesat sipas shkresës së dërguar nga bashkia Pukë dhe bashkia Pukë me datë 14.05.2018 i është drejtuar gjykatës së rrethit gjyqësor Pukë duke kërkuar likuidimin e shumave të tarifës së qerasë për fondin pyjor, sipar kontratës, për vitet 2016-2017.
- Me vendimin datë 20.07.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë është shprehur dhe ka vendosur që pala e paditur shoqëria òB.ò Sh.A., të përmbushë detyrimin kontraktual që rrjedh nga kontrata e qerasë nr. 26 prot., datë 03.02.2015, për vitet 2016-2017 në shumën **1,307,284** lekë.

- Gjykata e Apelit Shkodër ka lënë në fuqi Vendimin nr. 138, datë 14.04.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.
 - Nga zyra e tatim-taksave pranë bashkisë Pukë, shoqërisë òB.ò Sh.A., i është dërguar shkresa nr. 890/51 prot., datë 17.10.2017 òNjoftim detyrimi nga gjetjet e auditimit të KLSH-sëò, për diferenca në pagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në lidhje me lejet e ndërtimit nr. 909, datë 21.10.2013, nr. 910, datë 28.10.2013 dhe nr. 1046, datë 11.12.2013, si më poshtë:
 - Leje ndërtimi nr. 909 datë 21.10.2013 për objektin òBanesë me dy kate fjetje për nevojat e personelitò, me investitor shoqërinë òB.ò Sh.A., për sipërfaqen ndërtimore 150 m², për vlerën e pa paguar **109,917 lekë**.
 - Leje Ndërtimi nr. 910 datë 28.10.2013, për objektin òNdërtim banese me dy kate për zyra dhe fjetinaò, me investitor shoqërinë òB.ò Sh.A., për sipërfaqen ndërtimore 185 m², për vlerën e pa paguar **807,837 lekë**.
 - Leje ndërtimi nr. 1046 datë 11.12.2013, për objektin òVaskë për dekantimin e ujërave të galerisëò, me investitor shoqërinë òB.ò Sh.A., për sipërfaqen ndërtimore 328 m², për vlerën e pa paguar **220,671 lekë**.
 - Në total detyrimi për diferencat në taksën e ndikimit në infrastrukturë është **1,138,425 lekë**.
 - Shoqëria òB.ò Sh.A., i është drejtuar bashkisë Pukë me shkresën nr. 134 prot., datë 02.11.2020, ku ka kërkuar dërgimin e dy vërtetimeve për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020, për minieren Munellë dhe minierën Karma 2. Nga zyra e tatim taksave pranë bashkisë Pukë, subjekti është njoftuar me shkresën nr. 713/2 prot., datë 13.11.2020 òDërgim informacioni...ò.
 - Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. 117 (182) datë 01.03.2021, ka rrëzuar kërkesë padinë e shoqërisë òB.ò Sh.A., me objekt: òKonstatimi i pavlefshmërisë absolute të shkresës nr. 890/5 prot., datë 17.10.2017 “Njoftim detyrimi nga gjetjet e KLSH - së”ò.
 - Me shkresën nr. 89 prot., datë 07.05.2021 të shoqërisë òB.ò Sh.A., është kërkuar òPaisja me vërtetim për shlyerjen e taksave vendoreò dhe me shkresën nr. 1337/2 prot., datë 02.07.2021 të bashkisë Pukë është dërguar vërtetimi bashkëlidhur shkresës në fjalë, mbështetur në nenin 34/2 të Ligjit nr. 9920/2008 òPër detyrimet taimoreò, i ndryshuar.
- Duke pasur parasysh sa më sipër, si dhe faktin që bashkëlidhur ankesës në fjalë nuk ka asnjë dokument i cili të mbështesë pretendimet e supozuara, konkludojmë se ankesa e shoqërisë òB.ò Sh.A. nuk qëndron.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatuan diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera. Niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën 57% deri 99%, gjë që tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Pukë dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara.

Të ardhurat e Bashkisë Pukë për vitin 2020 janë realizuar në masën 96%, konkretisht nga 42,408 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 40,787 mijë lekë. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2019 në vitin 2020 kanë qenë 4,298 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar e vitit 2020 ka qenë 111,972 mijë lekë, transferta specifike faktike ka qenë 93,869 mijë lekë, nga FZHR ka pasur një shtesë me vlerën 34,892 mijë lekë. Totali i planifikuar i të hyrave për vitin 2020 ka qenë 458,591 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 86%, pra 394,931 mijë lekë.

Përdorimi i të ardhurave për vitin 2020, sipas treguesve të buxhetit, për të ardhurat e veta gjatë vitit 2020 ka qenë 48%.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *ËPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *ËPër sistemin e taksave vendore*, i ndryshuar; ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 *ËPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore*, neni 9 pika 1.3 germa *Ëç* dhe *Ëç*; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore*, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *ËPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, *ËPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 *ËPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor*, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 *ËPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njërive të vetëqeverisjes vendore*; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 *ËPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm* dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 25-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Pukë, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se fondi i krijuar për emergjencat civile nuk është në masën 4% e shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, ku referuar buxhetit përkatës të vitit 2020, ky fond duhej të ishte në vlerën 18,344 mijë lekë. Buxheti i caktuar nga Bashkia Pukë për emergjencat civile është llogaritur 1.7% e totalit të transfertës dhe të ardhurave të planifikuara për vitin 2020 sipas shkresës të MFE nr. 23189/1 prot., datë 24.12.2019.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 45/2019, datë 18.07.2019 *ËPër mbrojtjen Civile*, pika 1 e nenit neni 65 *ËBuxheti i bashkive*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 25-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masa që në të ardhmen, të parashikojë shpenzimet për emergjencat civile në nivelin e duhur, me qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe sigurimin e mbrojtjes civile për komunitetin.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se niveli i realizimit të investimeve të planifikuara paraqitet i ulët, ku për vitin 2020 është realizuar në masën 72%, ku nga vlera e planifikuar prej 97,867 mijë lekë është realizuar vlera 70,591 lekë me një diferencë prej 27,277 mijë lekë.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 *ōPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *ōPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *ōPër sistemin e taksave vendore*, i ndryshuar; ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 *ōPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *ōPër vetëqeverisjen vendore*, neni 9 pika 1.3 germa *ōcō* dhe *ōcō*; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *ōPër financat e vetëqeverisjes vendore*, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *ōPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, *ōPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 *ōPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor*, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 *ōPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njërive të vetëqeverisjes vendore*; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 *ōPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm* dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

(Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1., faqe 25-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pukë, të merren masa që planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar shpenzimet më të domosdoshme për nevojat e bashkisë Pukë.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2020, detyrimet në fund të periudhës ushtrimore janë në shumën 59,251 mijë lekë, nga të cilat me VKB-në nr. 91, datë 27.12.2019, është parashikuar të likuidohet vlera 7,000 mijë lekë, nga të cilat 3,000 mijë lekë, që i përkasin llogarisë 602 dhe 4,000 mijë lekë që i përkasin llogarive 230-231.

Nga planifikimi, konstatohet se në fund të vitit 2020, vlera e detyrimeve të planifikuara për vitin buxhetor është më e vogël, nisur nga fakti se planifikimi i buxhetit të vitit pasardhës hartohet dhe miratohet në muajin nëntor dhe detyrimet nuk kanë dalë të gjitha.

Në totalin e faturave të pa likuiduara për vitin 2020, faturat e llogarisë 602 paraqiten në shumën 5,692 mijë lekë ose 9.6% të totalit, ku shpenzimet për investime janë në shumën 43,486 mijë lekë ose 73.3% dhe shpenzimet gjyqësore janë në shumën 10,071 mijë lekë ose 17.1% e totalit.

Është i pa argumentuar fakti se referuar situatës së pasqyrave financiare të vitit 2020, megjithëse në llogarinë 520 ka gjendje monetare të pa përdorur, përsëri Bashkia Pukë ka detyrime kreditore të pa paguara dhe në vlera të konsiderueshme. Kështu në fund të periudhës së vitit 2019, në llogarinë 520 ka pasur gjendje në vlerën 67,083,955 lekë dhe në fund të vitit 2020 në llogarinë 520 paraqitet në vlerën 82,386,492 lekë. Pavarësisht se një pjesë e këtyre fondeve nuk mund të prekeshin për shkak se kanë qenë të specifikuara nga transfertat, pjesa tjetër mund të ishte përdorur për të shlyer plotësisht ose pjesërisht detyrimet e prapambetura.

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Pukë, nga data e faturës së kontraktorit, u konstatua se për vitin 2020, janë pa paguar gjithsej 16 fatura me vlerë 5,209 mijë lekë, nga të cilat 13 fatura i përkasin llogarisë 602, në vlerën 1,494 mijë lekë dhe 3 fatura i përkasin llogarive 230-231, në vlerën 3,715 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit për detyrimet ndaj vendimeve gjyqësore, u konstatua se deri në fund të vitit 2019 paraqitet vlera totale prej 10,941 mijë lekë. Gjatë vitit 2020 është likuiduar shuma prej 2,575 mijë lekë dhe mbetet për likuidim shuma prej 10,071 mijë lekë.

Sa më sipër, kjo bashki është afër klasifikimit me vështirësi financiare, pasi stoku i detyrimeve të prapambetura paraqitet rreth 17.7% e shpenzimeve vjetore të miratuara.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore*, neni 9 pika 1.3 germa *öçö* dhe *öçö*; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore*, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 *ËPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikat 2.1., faqe 25-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program dhe radhës së faturave, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

Menjëherë

4.2. Rekomandimi: Bashkia Pukë, Drejtoria Ekonomike, të marrë masa dhe të paraqesë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave dhe detyrimeve për vendimet gjyqësore në të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **59,251 mijë lekë**, nga faturat e papaguara dhe për vlerën **10,071 mijë lekë** nga vendimet gjyqësore (në datën 31.12.2020) si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim të plotë në kontabilitet.

Menjëherë

4.3. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masa që të ardhurat e pa përdorura në fund të vitit, të mos i mbartë në vitin pasardhës, por t'i përdorë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, kontraktuale dhe gjyqësore, sipas radhës kronologjike të krijimit të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e Pasqyrës A2, bashkëlidhur Raportit përfundimtar të auditimit, konstatohet se *për vitin 2019*, të ardhurat nga 44,031 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 19,969 mijë lekë ose 45%, pra me një mosrealizim në shumën 24,062 mijë lekë. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga defiqiti i krijuar nga pandemia Covid-19, ndërsa *për vitin 2020*, të ardhurat nga 42,408 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në masën 40,787 mijë lekë 96%. Në planifikimin e të ardhurave konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve të familjarëve, përfshirë taksën e tokës, nuk është përlogaritur, pra planifikimi i të ardhurave është bërë me rezervë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 *ËPër Financat e Vetëqeverisjes Vendore* i ndryshuar, neni 5, *ËParime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore*, neni 54, *ËRaportimi financiar* nën-pika c, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore*, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV *ËProcedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave* pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 *ËPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes*

dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 25-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, gjatë hartimit të projekt/planit të buxhetit, të planifikojë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e degës së thesarit sipas akt-rakordimeve të financës, buxhetit dhe kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Pukë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2020 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Pukë SHA me NUIS òK79121308Sò, e cila është shoqëri aksionare me objekt òShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tijò. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 137,779 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 137,779,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pukë në òUjësjellës Kanalizime Pukë SHAò, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020, më konkretisht në llogarinë 26 òPjesëmarrje në kapitalet e vetaò në kundërshtim me UMF nr. 64, datë 22.07.2014 òPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 òAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata jo materialëò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 òTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, nëpërmjet Nënpunësit zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek òUjësjellës Kanalizime Pukë” Sh.A. me vlerë 137,423,000 lekë, në debi të llog. 26 òPjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Brenda datës 31.03.2021

7. Gjetje nga auditimi: Në fund të vitit 2020, llogaria 466 òKreditorë për mjete në ruajtjeò, paraqitet në vlerën 11,346,594 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga analiza e kësaj llogarie, **konstatohet se:** gjatë vitit 2020 Drejtoria e Financës ka të dokumentuar ngurtësimet në vlerën 11,346,594 lekë për 36 subjekte. Shtesat janë në vlerën **2,723,431 lekë** dhe likuidimet e kryera në vlerën **2,110,116 lekë për 3 subjekte**. Sipas akt rakordimeve midis Bashkisë Pukë dhe degës së thesarit Pukë, **konstatohet se për 29 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 9,188,341 lekë, sipas aneksit nr. 6, pika 2, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në degën e thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga drejtoritë e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Veprimet e mosveprimet janë në kundërshtim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, të

saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë pranë Degës së Thesarit Pukë për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi:Për vitin 2020 struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 79, datë 27.12.2019. Rezulton se në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Pukë nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të asetëve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, sipas UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö*, në kundërshtim me kapitullin III *ËRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyreö*, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö*; nenin 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 *ËPër pronat e paluajtshme të shtetitö*, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 *ËPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendoreö*, UMF nr. 3, datë 18.07.2002 *ËPër inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendoreö*, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 *ËPër mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publikeö*, me qëllim rritjen e mundësisë e të ardhurave nga dhënia me qira si rjedhoj nuk është krijuar regjistri i asetëve për të gjitha pronat e transferuara nga ish komunat.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 49-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi:Bashkia Pukë, të marrë masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të asetëve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Pukë dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi:Për vitet 2019-2020 janë lidhur dhe zbatuar 11 kontrata në vlerën 108,626,177 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, ministritë e linjës dhe FZHR. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogarite e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, që kanë lidhje me 7 kontrata, ku vlera e mbetur e palikujduara e tyre prej 33,657,277 lekë nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 *“Të ardhura të caktuara për t'u përdorur”* Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *“Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”* Kapitulli I, pika 1 dhe Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare*

vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a, b, c, 18/a, b, Kreu III pika 32.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 49-65të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi:Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Pukë, të kryejë të gjitha veprimet e kontabilizimit sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike për kontratat e lidhura për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, duke pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar që nga çelja e fondeve, me konstatimin e shpenzimit (mbërritja e faturës), deri në kapitalizmin e aktivitetit dhe jo thjesht, kur ndërhyjnë pagesa, pasi evidentimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin gradual të tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi:Llogaria 231 ÷Për aktive afatgjata materialeö më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 153,198,003 lekë, në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 168,337,577 lekë, e cila përfaqëson, vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre, kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 ÷Aktive afatgjata materialeö. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Drejtoria e financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2020, sipas aneksit nr. 9 pika 2. bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, ÷Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, ÷Aktive afatgjata materialeö dhe pika 33.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 49-65të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi:Drejtoria Ekonomike të marrë masa për sistemin e llogarisë 231 ÷Për aktive afatgjata materialeö, në mënyrë që kjo llogari të pasqyrojë vlerën reale të Aktive afatgjata materiale duke plotësuar dhe mangësitë e dokumentacionit në listat analitike.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitö neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 ÷Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisëö, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 ÷Për vetëqeverisjen vendoreö, dhe pikën 93, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö, nga ana e Titullarit të njësisë publike Bashkia Pukë, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi Zbatues të ndiqet procesi me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,300,000 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Pukë ushtrojnë aktivitetin 3 subjekte të cilat tregtojnë hidrokarbure, karburante. Subjekte të licencuar për tregtimin e lëndëve djegëse nuk ka. Aktualisht, detyrimet për pajisjen me autorizim i ka shlyer vetëm ÷K.ö Shpk, ndërsa ÷S.ö Shpk dhe ÷N. O.ö Shpk vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin të papajisur me autorizimin përkatës.

1. Subjekti ÷K.ö Shpk, ka kryer pagesat e duhura për licencën e tregtimit të karburanteve,

por jo për gazin e lëngshëm dhe rrjedhimisht është debitor për vlerën 100,000 lekë.

2. Subjekti òS.ò Shpk, ka aplikuar dhe paraqitur dokumentacion, por dokumentacioni nuk është i plotë dhe vazhdon aktivitetin pa licencë. Ky subjekt është debitor për vlerën e papaguar 1,100,000 lekë.

3. Subjekti òN. O.ò Shpk, i cili ushtron aktivitet në njësinë Administrative Gjegjan, Bashkia Pukë nuk disponon informacion. Ky subjekt është debitor për vlerën e papaguar 1,100,000 lekë.

Pagesat e kryera deri në momentin e auditimit dhe vlerat debitoare janë paraqitur në Pasqyrën A27, në Aneksat bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vlera e papaguar prej **2,300,000 lekë**, përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 *òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë* i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa òbò, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 25-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Pukë, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **2,300,000 lekë**, sipas Aneksëve bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, Pasqyra A27. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Të ardhura të munguara nga dhënia me qera e aseteve të Bashkisë, si troje, toka bujqësore, pyje e kullota. Nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në zyrën e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Pukë, u konstatua se për vitin 2020 ka pasur gjithsej 38 kontrata me persona fizikë për përdorim të hapësirave publike, për një vlerë totale prej 441,524 lekë, nga të cilat janë pa likuiduar 2 subjekte, në vlerën 19,008 lekë, konkretisht A. B. dhe N. M. në vlerën 9,504 lekë secili. Vlera **19,008 lekë** përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Krahas hapësirave publike, Bashkia Pukë ka lidhur 17 kontrata me subjekte juridike, me afat nga 1 deri në 35 vjet, nga të cilët është pa likuiduar vlera totale prej 7,448,956 lekë, e cila përbën mungesë të ardhurash për Bashkinë Pukë. Nga kjo vlerë, subjekti E. U. shpk ka shlyer detyrimin gjatë vitit 2021. Rrjedhimisht, vlera debitoare në fund të vitit 2020 ngelet **6,351,472 lekë**.

Sa më sipër, është në kundërshtim me: ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 *òKodi Civil i Republikës së Shqipërisë* i ndryshuar; ligjin nr. 48/2014 *òPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*; ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 *òPër tokën*, i ndryshuar; ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 *òPër tokat bujqësore të pandara*, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 *òPër tokat bujqësore të pandara*, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, *òPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për taji lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM

nr. 54, datë 5.2.2014 *ËPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 *ËPër procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandaraö, etj.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 25-49të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandim: Bashkia Pukë të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar (përfshirë vlerën e kamatëvonesave) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **6,370,480 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se taksa e ndikimit në Infrastrukturë, për vitin 2020 është realizuar në shumën 889,000 lekë nga 1,319,000 lekë të planifikuara ose në masën 67%.

Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2019 janë dhënë 17 leje legalizimi për 2,670.6 m² ndërtim, me vlerë investimi prej 87,782,622 lekë, në vlerën e taksës prej 438,913 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 136,050 lekë, duke mbetur pa shlyer 10 posedues të lejeve të legalizimit të një sipërfaqeje prej 1,842.8 m², me vlerë **302,863 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2020 janë dhënë 12 leje legalizimi për 1,042.7 m² ndërtim, me vlerë investimi prej 34,273,549 lekë, në vlerën e taksës prej 171,368 lekë, nga e cila është likuiduar vlera 96,836 lekë, duke mbetur pa shlyer 4 posedues të lejeve të legalizimit të një sipërfaqeje prej 453.5 m² me vlerë **74,532 lekë**, e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, *ËPër legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeö* i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, *ËPër sistemin e taksave vendoreö*, i ndryshuar; VKB Pukë *ËPër miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Pukëö*, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 25-49të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandim: Bashkia Pukë nëpërmjet bashkëpunimit institucional të kërkojë ASHK-së, Drejtoria Shkodër, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Pukë. Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe administrimit të territorit, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e listuar si debitorë në Pasqyrën A5, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, bazuar në legjislacionin tatimor.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në bazë të përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga zyra e tatim-taksave vendore në Bashkinë Pukë, rezultoi se janë 90 subjekte debitorë nga biznesi. Numri dhe vlera e debitorëve nga biznesi (për taksat dhe tarifave vendore), krahasuar me vitin 2019 është ulur, nga 106 në 90 biznese, ndërsa vlera debitorë ka ardhur duke u rritur, nga 10,080,960 lekë që ishte në fund të vitit 2019 ka shkuar në 14,909,764 lekë në fund të vitit 2020. Vlera prej **14,909,764 lekë** përbën mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë Pukë.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 *ËPër vetëqeverisjen vendoreö* i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendoreö* i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 *ËPër*

sistemin e taksave vendoreë, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 *ËPër Procedurat Tatimoreë*, me ndryshime, Kreut XI, *ËMbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguaraë*, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 *ËKodi Penal i RShë* me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 *ËPër vetëqeverisjen vendoreë*, i ndryshuar neni 9 *ËTë drejtat dhe përgjegjësitëë* pika 1.3., neni 35, *ËTë ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendoreë*, me ligjin nr. 68/2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendoreë* i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 *ËPër sistemin e taksave vendoreë*, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 25-49të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandim: Bashkia Pukë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj **90 subjekteve** debitore në vlerën prej **14,909,764 lekë** (sipas *Pasqyrave në Anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit*), duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

- a. *T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.*
- b. *Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit*, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
- c. *Në funksion të mbledhjes së detyrimit të paguar*, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.
- d. *Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset*, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Pukë, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se regjistrat e familjeve fermere, nuk janë përditësuar sipas të dhënave që duhet të disponojë ZAMT në Bashki dhe në Qark apo ASHK Pukë, për numrin e familjeve që kanë përfituruar tokë në bazë të ligjit për ndarjen e tokës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 *ËPër sistemin e taksave vendoreë*, i ndryshuar, nenet 23 dhe 24.

Për vitin 2019 nuk kanë paguar 397 familje, ndërsa për vitin 2020 nuk kanë paguar 490 familje, për një vlerë totale prej 1,001,460 lekë. (Pasqyra A16, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Vlera prej **211,860 lekë**, e cila vjen nga diferenca e familjeve që nuk paguajnë me familjet e përjashtuara me VKB nga pagesa e detyrimeve, përbën të ardhura të munguara për bashkinë Pukë, nga mosarkëtimi i taksave të familjarëve nëpërmjet agjentit tatimor Ujësjiellës Kanalizime Puka Sh.A. (Pasqyra A17)

Vlera prej **673,946 lekë**, nga shuma e të ardhurave të planifikuara por të pa arkëtuara nga Njësitë Administrative Gjegjan, Qerret, Rrapë dhe Qelëz, për vitin 2020, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 *ËPër tokënë*, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 5,313 familje. Për periudhën 2015-2020, nga auditimi rezultoi vlera debitorë **4,597,864 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë. Kjo vlerë debitorë është e pakontabilizuar.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 *ËPër sistemin e taksave vendoreë*, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 *ËPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëë* i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligjin nr. 139/2015 *ËPër vetëqeverisjen vendoreë* i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendoreë* i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr.

9975, datë 28.7.2008, *ËPër Taksat Kombëtare*, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, *ËPër Taksat Kombëtare*, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 25-49të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandim: Bashkia Pukë, të ngrëjë grup pune me specialistë të fushës, për të hartuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Pukë dhe Qarku Shkodër). Për familjet fermerë debitorë të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën **4,597,864 lekë** dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.

4.2. Rekomandim: Bashkia Pukë, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerave debitorë. Gjithashtu Bashkia Pukë të bashkëpunojë me ËUjësjellës Kanalizime Pukaë Sh.A. për arkëtimin e vlerës debitorë prej **885,806 lekë** dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative këtij agjenti tatimor.

4.3. Rekomandim: Bashkia Pukë, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifave apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Pukë, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Sektori i tatim-taksave vendore, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, nga subjektet që kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit, të pajisur me leje ndërtimi nga Bashkia Pukë, 8 prej tyre nuk kanë paguar detyrimet vendore në vlerën totale **260,000 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Pukë, ndërsa për 4 subjekte nuk ka informacion.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 *ËPër procedurat tatimore* neni 40, *ËRegjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtare*, pika 1, neni 43 *ËPërditësimi i të dhënave të regjistrimit* pika 1/1; ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 *ËPër Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*, i ndryshuar, neni 22, *ËDetyrimi për regjistrim*, pika 4; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2010 *ËPër sistemin e taksave vendore*, i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015 *ËPër vetëqeverisjen vendore* i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore* i ndryshuar, VKB, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 25-49të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandim: Bashkia Pukë të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruarra për vitet 2019-2020, pavarësisht nëse kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Pukë dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, si dhe të nxjerrin njoftim detyrimet për taksat dhe tarifave vendore. Sipas listimit në Anekse, Pasqyra A26 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të ndjekin të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej **260,000 lekë** nga këto detyrime vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë, për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil:

Mbështetur në nenin 15, shkronja (c), të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 *ōPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*, nenin 58 të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *ōPër nëpunësin civilō* i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 *ōPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilō*, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë**, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH^{së}, për periudhën (01.01.2020 deri 31.12.2020), të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për punonjësit e mëposhtëm:

Për problematikat e konstatuara në lidhje me Pasqyrat financiare, si më poshtë vijon;

1. Znj. F. P., me detyrë Drejtoreshë e Financës.

- Mos regjistrimi në kontabilitet për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat Financiare për vitin 2020 të Ujësjetës Kanalizime Pukë Sh.A.ō në vlerë 137,423,000 lekë, në debi të llog. 26 *ōPjesëmarrje në kapitalet e vetaō* dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

- Mos zbatim të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 *ōPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlō* Kapitulli I, pika 1. dhe Udhëzimi i MFE nr.8, datë 9.3.2018 *ōPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeō*, referuar raportit të auditimit.

Për problematikat e konstatuara në lidhje me të ardhurat, si më poshtë vijon;

2. Z. N. A., me detyrë Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave vendore.

Për shkeljet e konstatuara:

Mos zbatimikërkesave të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 *ōKodi Civil i Republikës së Shqipërisëō* i ndryshuar; ligjit nr. 48/2014 *ōPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtareō*; ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 *ōPër tokënō*, i ndryshuar; ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 *ōPër tokat bujqësore të pandaraō*, VKM-sënr. 531, datë 21.08.1998 *ōPër tokat bujqësore të pandaraō*, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM-sënr. 373, datë 20.06.2018, *ōPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitō*, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për tō lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM-sënr. 54, datë 5.2.2014 *ōPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreō*; UKM-sënr. 1, datë 18.07.2012 *ōPër procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandaraō*, etj.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT